

# S F I D A T

## E NJËSIVE TË QEVERISJES

## VENDORE NË LUFTËN

# KUNDËR KORRUPSIONIT

*Një vlerësim i sistemit anti-korrupsion  
në 20 bashki të Shqipërisë*



BASHKIMI EVROPIAN  
DELEGACIONI NË SHQIPËRI

Financuar nga Bashkimi Evropian



Institute for Democracy and Mediation  
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

**RiskMonitor**

# S F I D A T

E NJËSIVE TË QEVERISJES

VENDORE NË LUFTËN

KUNDËR KORRUPSIONIT

Një vlerësim i sistemit  
anti-korrupsion në  
20 bashki të Shqipërisë

Projekti: CIVILISC – Instrumente të Shoqërisë Civile kundër Korrupsionit, zbatuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim në bashkëpunim me Fondacionin RiskMonitor, Bullgari.

Tiranë, 2016



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian nën Programin "Civil Society Facility Civic Initiative and Capacity Building - Lot 1: "Promotion of Good Governance and Fight against Corruption".

*Autorë:*

**Dalina Jashari, PHD**

Menaxhere e Projektit

**Shefqet Bruka**

Ekspert i Lartë i Çështjeve Vendore

**Mirsada Hallunaj**

Hulumtuese

**INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM**

Address: Rr. Shenasi Dishnica, 1

PO Box 8177 Tirana, Albania

Tel: (+355 4) 2400241/ +355 4 2400640

[www.idmalbania.org](http://www.idmalbania.org)

<https://www.facebook.com/IDMAlbania/>

**Sqarim**

Ky botim është përgatitur me mbështjetjen e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e autorëve dhe nuk pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

# PËRMBAJTJA

<b>PËRMBLEDHJE</b>	<b>4</b>
<b>1. HYRJE</b>	<b>6</b>
<b>2. QASJA METODOLOGJIKE</b>	<b>9</b>
<b>3. VETËQEVERISJA VENDORE NË SHQIPËRI, POLITIKAT, KUADRI RREGULLATOR DHE STRUKTURAT E LUFTËS KUNDËR KORRUPSIONIT</b>	<b>14</b>
3.1 Përmbledhje e Përgjithshme Legjislative e NJQV-ve	15
3.2 Politikat, Kuadri Rregullator e Strukturat e Luftës kundër Korrupsionit	15
3.2.1 Kuadri i Politikave të Luftës Kundër Korrupsionit	16
3.2.2 Kuadri Rregullator i Luftës kundër Korrupsionit	17
3.2.3 Dokumente Ndërkombëtare dhe Konventa	17
3.2.4 Legjislacioni Kombëtar	18
3.3 Kuadri Rregullator Financiar	21
<b>4. INSTRUMENTET ANTI-KORRUPSION TË NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE</b>	<b>23</b>
<b>5. NIVELI I AKTIVIZIMIT DHE KAPACITETEVE TË OSHC-VE VENDORE NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT</b>	<b>30</b>
5.1 Njohuritë dhe kapacitetet e OSHC-ve në luftën kundër korrupsionit në nivel vendor	31
5.2 Vështirësi dhe sfida	34
<b>6. NIVELI I KORRUPSIONIT NË NJQV: PERCEPTIME TË OSHC-VE</b>	<b>36</b>
<b>7. ORGANIZATAT VENDORE TË SHOQËRISË CIVILE DHE NJËSITË E QEVERISJES VENDORE DREJT NJË QASJEJE TË PËRBASHKËT</b>	<b>39</b>
<b>8. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME</b>	<b>43</b>
<b>SHTOJCAT</b>	<b>47</b>
Shtojca I. Profili i Bashkive	47
Shtojca II. Pyetjet e drejtuar drejtuesve të NJQV-ve	61
Shtojca III. Përmbledhje e përgjigjeve të intervistave me NJQV-të	63

# PËRMBLEDHJE

Kryesisht në dy vitet e fundit, Shqipëria ka hartuar dhe miratuar një sërë masash ligjore dhe politikash në kuadër të luftës kundër korrupsionit si dhe organizimit e funksionimit të qeverisjes vendore. Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020<sup>1</sup> edhe Plani i Veprimit parashikojnë një sërë veprimesh që synojnë forcimin e rolit të shoqërisë civile, rritjen e pjesëmarrjes dhe bashkëpunimin e qytetarëve. Përveç kësaj, administrata e institucioneve të qeverisjes vendore duhet të jetë sa më e aftë për të menaxhuar përgjegjësitë e reja në nivel bashkie, përfshirë luftën kundër korrupsionit, të dala nga ndarja e re administrativo-territoriale<sup>2</sup> dhe Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore<sup>3</sup>.

Lufta kundër korrupsionit në nivel vendor duhet të përfshijë të gjithë aktorët e shoqërisë dhe në këtë kontekst angazhimi i organizatave të shoqërisë civile (OSHC) në nismat anti-korrupsion mbetet një mjet i fuqishëm për të forcuar përpjekje të tilla sipas një qasjeje me pjesëmarrje qytetare.

NJQV-të e vogla/të mesme në Shqipëri nuk kanë ndërtuar ende instrumente (që burojnë nga legjislacioni në fuqi) për të trajtuar dhe parandaluar praktikat korruptive në bashkitë e tyre. Ato nuk kanë as një kuadër të qartë masash për të rritur bashkëpunimin me OSHC-të vendore. Nga ana tjetër, organizatat e shoqërisë civile dhe njësitë

1 Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 247, datë 20.03.2015

2 Ligji Nr. 115/2014 "Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë"

3 [http://www.ceshtjetvendore.gov.al/files/pages\\_files/Decentralisation\\_Strategy\\_Final\\_-\\_Feb\\_2015\\_-\\_English.pdf](http://www.ceshtjetvendore.gov.al/files/pages_files/Decentralisation_Strategy_Final_-_Feb_2015_-_English.pdf)

e qeverisjes vendore duhet të zotërojnë kapacitete për të krijuar dhe zhvilluar mekanizmat e duhur për të luftuar korrupsionin. Ndërkohë që në disa njëri të qeverisjes vendore, OSHC-të vendore duhet të rrisin kapacitetet e tyre organizative dhe ato të burimeve njerëzore, në një numër të konsiderueshëm të NJQV-ve të tjera të vogla organizatat e shoqërisë civile janë pothuajse inekzistente.

Njësitë e qeverisjes vendore duhet të marrin masa të menjëhershme për të krijuar instrumente anti-korrupsion dhe për të zhvilluar kapacitetet e administratës së tyre me qëllim zbatimin dhe matjen e ndikimit të kornizës ligjore dhe politikave anti-korrupsion. Nga ana tjetër, OSHC-të vendore duhet të përqendrojnë punën e tyre drejt nismave anti-korrupsion dhe qeverisjes së mirë si dhe të punojnë për të përmirësuar komunikimin dhe bashkëpunimin e tyre me njësitë e qeverisjes vendore.

# 1. HYRJE

Korrupsioni është një çështje e rëndësishme për shoqërinë në përgjithësi dhe lufta kundër tij është një nga sfidat më të mëdha të qeverive dhe të shoqërisë në tërësi. Kjo është një “betejë” dinamike dhe e vazhdueshme, e cila nuk mund të fitohet vetëm duke krijuar kornizat e duhura ligjore.

Lufta kundër korrupsionit është një nga pesë prioritetet kyçe të identifikuara nga Komisioni Evropian si kusht për hapjen e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë. Dokumentet kombëtare<sup>4</sup> të miratuara nga qeveria në kuadër të procesit të integritetit theksojnë rëndësinë e pjesëmarrjes aktive të shoqërisë civile. Kjo e fundit luan një rol të rëndësishëm në rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe në luftën kundër korrupsionit.

Studimet kanë treguar se pjesëmarrja aktive e shoqërisë civile në luftën kundër korrupsionit ndikohet nga tre faktorë kryesorë: (i) ekzistenca e një kuadri ligjor që u mundëson organizatave të shoqërisë civile (OSHC-ve) pjesëmarrjen pa kufizime politike dhe juridike (ii) përqasja bashkëpunuese e qeverive me shoqërinë civile (iii) angazhimi efektiv të organizatave të shoqërisë civile në luftën kundër korrupsionit.<sup>5</sup>

Gjatë viteve të fundit, qeveria shqiptare ka bërë përpjekje të

<sup>4</sup> *Udhërrëfytesa për 5 prioritetet kyçe* ka për qëllim përmbushjen e pesë prioritetëve kyçe të vendosura nga Komisioni Evropian si kusht për hapjen e negociatave të pranimit dhe Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE), i cili shërben si një mjet planifikimi për masat për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizimit Asocimit (MSA).

<sup>5</sup> <https://www.oecd.org/cleangovbiz/CivilSocietyEmpowermentDraft.pdf>

rëndësishme për të trajtuar çështjen e korrupsionit dhe për të nxitur pjesëmarrjen aktive të shoqërisë civile. Në kuadër të luftës kundër korrupsionit, Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore është emëruar si Koordinator Kombëtar për Anti-Korrupsionin, detyra kryesore e të cilit është bashkërendimi i aktiviteteve anti-korrupsion të institucioneve shtetërore dhe të organeve dhe institucioneve të pavarura në nivel qendror dhe vendor. Në kushtet e angazhimit të OSHC-ve në hartimin e politikave, në dy vitet e fundit janë ndërmarrë nisma ligjore për të përmirësuar rolin e këtyre të fundit në këtë proces siç është: Rezoluta për Njohjen dhe Forcimin e Rolit të Shoqërisë Civile në Procesin e Zhvillimit Demokratik të Vendit<sup>6</sup> dhe ligji “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile”.<sup>7</sup>

Përveç objektivave të përcaktuara në dokumentet strategjike dhe rregullatore, dy progres raportet e fundit të viteve 2014 dhe 2015 të Komisionit Evropian kanë theksuar disa sfida me të cilat përballen qeveritë vendore dhe shoqëria civile në përpjekjet e tyre për të luftuar korrupsionin. Raporti i KE-së i vitit 2014 theksoi se “Autoritetet vendore nuk kanë zhvilluar ende një dialog gjithëpërfshirës me shoqërinë civile dhe komunitetet vendore” dhe “nevojiten përpjekje të mëtejshme për të forcuar kapacitetet administrative të njësive të qeverisjes vendore, për t’u mundësuar atyre që të ushtrjnë autoritetin e tyre dhe zbatojnë legjislacionin”.<sup>8</sup> Të njëjtat sfida janë theksuar sërish në Raportin e KE-së në vitin 2015: “... qeverisja vendore vazhdon të jetë e ndjeshme ndaj korrupsionit...” Në nivel vendor, bashkëpunimi (me shoqërinë civile) mbetet i dobët “... Kapaciteti i rrjetit anti-korrupsion në ministri dhe në nivel vendor duhet të forcohet”.<sup>9</sup>

Raporti i titulluar “Instrumentet anti-korrupsion në njësitë e qeverisjes vendore- pasqyrë vlerësuese në 20 bashkitë (të vogla e të mesme)”, ka për qëllim të vlerësojë mekanizmat aktualë dhe nevojat e NJQV-ve dhe OSHC-ve në luftën kundër korrupsionit në nivel vendor. Pjesa e parë e tij ofron një pasqyrë të kuadrit ligjor ekzistues në vend, i cili përcakton vizionin ndaj luftës kundër korrupsionit

6 Miratuar nga Parlamenti më 24 Dhjetor, 2014

7 Raport, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

8 Progres Raporti i KE për Shqipërinë, 2014

9 Progres Raporti i KE për Shqipërinë, 2015



në nivel vendor. Dy seksionet e tjera të këtij raporti ofrojnë një pasqyrë mbi instrumentet ekzistuese me qëllim parandalimin dhe përballjen ndaj korrupsionit si dhe rritjen e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje në 20 bashkitë e vendit. Përveç kësaj, në aspektin e burimeve njerëzore dhe të menaxhimit, këto seksione vlerësojnë nevojat e NJQV-ve dhe OSHC-ve vendore për të përmirësuar përpjekjet e tyre për të luftuar korrupsionin në nivel vendor.

“Vlerësimi i mekanizmave anti-korrupsion në njësitë e qeverisjes vendore” publikohet në kuadër të projektit “CIVILISC – Instrumente të Shoqërisë Civile kundër Korrupsionit”, i cili ka për qëllim fuqizimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të shoqërisë civile në bashkitë e vogla/të mesme për të promovuar qeverisjen e mirë dhe luftën kundër korrupsionit. Ky vlerësim përmbyll fazën e parë të projektit dhe kontribuon në konsolidimin e fazave të mëvonshme të projektit të cilat do të fokusohen në zhvillimin e kapaciteteve të OSHC-ve vendore. Të dhënat dhe informacioni i marrë gjatë vlerësimit do të shërbejë edhe si bazë për monitorimin e ardhshëm e të vazhdueshëm dhe vlerësimin e përpjekjeve anti-korrupsion të ndërmarra nga njësitë e qeverisjes vendore.

## 2. QASJA METODOLOGJIKE

Metodologjia për vlerësimin e mekanizmave anti-korrupsion, e përgatitur së bashku nga IDM dhe RiskMonitor është bazuar në përvojën e mëparshme të këtij fondacionit në Bullgari në analizimin dhe vlerësimin e rrezikut ndaj korrupsionit të administratës së Bashkisë së Sofjes.<sup>10</sup>

Metodologjia e raportit të paraqitur në këtë dokument është hartuar konkretisht për të:

- Vlerësuar kapacitetet aktuale dhe nivelin e përgatitjes së 20 bashkive të vendit për të zbatuar masa anti-korrupsion në përputhje me Strategjinë Kombëtare Anti-korrupsion dhe Strategjinë e Decentralizimit 2015-2020.
- Identifikuar mangësitë dhe fushat e nevojshme për të asistuar njësitë e qeverisjes Vendore
- Vlerësuar kapacitetet aktuale të OSHC-ve vendore për t'u angazhuar në nisma kundër korrupsionit në nivel vendor.
- Kontekstualizuar aktivitetet e projektit CIVILISC me qëllim ndërtime të kapaciteteve dhe ndikimin e OSHC-ve në luftën kundër korrupsionit.

<sup>10</sup> Në vitin 2014-2015, RiskMonitor ka përgatitur një raport vlerësues të masave jo-represive për të luftuar praktikatat korruptive si dhe për të parandaluar këtë fenomen. Rezultatet e këtij raporti kanë ndihmuar administratën për të informuar dhe hartuar strategjinë e parë anti-korrupsion të kësaj bashkie si dhe për të hartuar një seri trajnimesh tematike për administratën e saj. Kjo strategji përmban një kuadër gjithëpërfshirës për vlerësimin e riskut ndaj korrupsionit si dhe një sërë indikatorësh me qëllim matjen e rrezikut ndaj korrupsionit të zyrave të ndryshme të administratës brenda bashkisë.

Metodologjia e përdorur për këtë raport vlerësimi ndërthur disa teknika kërkimi si: shqyrtim literature, realizimi i intervistave të strukturuar dhe diskutime me grupe tematike.

**Rishikimi i burimeve dhe analiza e kuadrit të përgjithshëm** grupi përgatitor analizoi dhe rishikoi dokumentet politike dhe legjisllacionin aktual të cilat përcaktojnë mekanizmat për funksionimin e qeverisjes vendore dhe anti-korrupsionit në Shqipëri. Në këtë kuadër u mblo dhën dhe përdorën një gamë e gjerë dokumentesh ligjorë me qëllim analizimin nëse kuadri ligjor politik dhe rregullator krijon hapësirat e përshtatshme për njësitë e qeverisjes vendore dhe organizatat vendore të shoqërisë civile për të parandaluar dhe luftuar fenomenin e korrupsionit.

Bazuar në analizën e kryer të kuadrit ligjor, u formulua një set me 12 instrumente/mekanizma, të cilat duhet të ndërtohen nga vetë bashkitë me qëllim parandalimin dhe ndëshkimin e korrupsionit si dhe rritjen e angazhimit qytetar. Gjithashtu, grupi i kërkimit shqyrtoi informacionin e disponueshëm në versionin elektronik (p.sh., faqet zyrtare të internetit të bashkive të synuara në projekt) si dhe grumbulloi një sërë të dhënash socio-ekonomike për secilën prej këtyre bashkive. Bazuar në këto të dhëna, është përpunuar një profil për secilën prej këtyre bashkive, i cili gjendet në shtojcat e këtij raporti.

### *Intervista të strukturuar me informatorët kyç në bashki*

Puna në terren e grupit përgatitor të këtij raporti synoi të zgjerojë informacionin e përftuar nga burimet e shfrytëzuara gjatë analizës së kuadrit të përgjithshëm, duke analizuar specifikisht 12 mekanizmat anti-korrupsion të përftuara nga analiza e kuadrit ligjor. Intervistat e strukturuar janë zhvilluar me kryetarët/ nënkryetarët e secilës prej 20 bashkive të synuara në projekt. Intervista<sup>11</sup> përmbante 16 pyetje gjithsej nga të cilat 12 pyetje që kishin të bënin specifikisht me ekzistencën apo jo të 12 instrumenteve anti-korrupsion dhe 4 pyetje të tjera<sup>12</sup> të cilat synonin të vlerësonin nevojat (në burime njerëzore dhe institucionale) e bashkive si dhe kërkesa për rekomandime për rolin që duhet të luajnë organizatat vendore të shoqërisë civile në rritjen e mirë-qeverisjes në nivel vendor.

11 Shih Shtojcën II për pyetjet.

12 Pyetjet 13, 14 dhe 16 jepen në figurat 2 dhe 3

### *Fokus grupet (FG)*

Diskutimet në fokus grupet e organizuara me organizatat vendore të shoqërisë civile synuan që të mbledhin informacion në lidhje me nivelin e njohurive të OSHC-ve rreth mekanizmave anti-korrupsion që ekzistojnë në bashkitë përkatëse ku ata shtrijnë punën e tyre. Këto takime shërbyen gjithashtu për të kuptuar nivelin e kuptueshmërisë nga ana e OSHC-ve mbi ndërhyrjet dhe fushat e veprimit që ata duhet të ndërmarrin si aktor kyç në luftën kundër korrupsionit në nivel vendor.

Shoqëria civile dhe qytetarët luajnë një rol shumë të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit, veçanërisht në kontekstet vendore, për këtë arsye, bashkëpunimi ndërmjet këtyre dy aktorëve është thelbësor për të vënë në praktikë principet e transparencës, integritetit, llogaridhënies dhe angazhimit qytetar.

Nëpërmjet këtij raporti është synuar që të arrihen objektivat specifike si më poshtë:

- Identifikimi i organizatave të shoqërisë civile të cilat shtrijnë aktivitetin e tyre në bashkitë e Klosit, Memaliajt, Urës Vajgurore, Cërrikut, Gramshit, Divjakës, Tepelenës, Libohovës, Devollit, Selenicës, Prrenjasit, Librazhdit, Maliqit, Lushnjës, Shijakut, Belshit, Vorës, Bulqizës, Vaut të Dejës dhe Hasit.
- Identifikimi i kapaciteteve aktuale dhe nivelit të njohurive të OSHC-ve në monitorimin e performancës së bashkive në kuadër të luftës kundër korrupsionit
- Identifikimi i vështirësive kryesore të cilat pengojnë në aktivizimin e OSHC-ve në nisma anti-korrupsion në nivel vendor.

Tabela më poshtë jep të dhëna mbi organizimin e fokus grupeve.

Fokus Grupi	Qyteti	Data	Nr. i pjesëmarrësve	Bashkia nga të cilat vinin OSHC-të pjesëmarrëse
1 <sup>ST</sup>	Elbasan		15	Librazhd, Prrenjas, Gramsh, Belsh, Cërrik, Devoll, Maliq, Vore, Shijak
2 <sup>ND</sup>	Bulqiza		11	Bulqiza, Has, Vau i Dejës, Klos
3 <sup>RD</sup>	Fier		10	Selenica, Lushnja, Divjakë, Tepelene, Libohova, Memaliaj, Ura Vajgurore

### Kufizime të metodologjisë

Ky raport vlerësimi është përqendruar në 20 nga 61 njësitë e qeverisjes vendore të vendit, për këtë arsye, ai nuk jep një pasqyrim përgjithësues të objektivave të tij. Identifikimi i OSHC-ve vendore që veprojnë në bashkitë e përzgjedhura të projektit ka qenë një sfidë si rezultat i konfuzionit në gjetjen e të dhënave të besueshme dhe mungesa e një baze të dhënash të konsoliduar për OSHC-të. Informacioni në lidhje me OSHC-të që veprojnë në Shqipëri është përftuar nga faqja e internetit të Parlamentit (regjistri elektronik i OSHC-ve<sup>13</sup>) dhe faqja e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.<sup>14</sup> Të dhëna të tjera janë gjetur në raportet e tjera të publikuara nga OSHC-të dhe institutet kërkimore nëpërmjet studimeve të ndryshme. Shumica e OshC kanë qendrat e tyre në Tiranë apo në qytetet e tjera të mëdha të Shqipërisë. Ekipi kërkimor u përpoq të kontaktojë dhe të mbledhë në diskutimet e fokus grupeve sa më shumë OSHC të vogla të cilat shtrijnë punën e tyre në nivel vendor vetëm në bashkitë e synuara në projekt. Vështirësi janë hasur gjithashtu në gjetjen e OSHC-ve vendore në bashkitë e reja të sapo-themeluara nga ndarjen e re territoriale në Shqipëri. Sa i përket mbulimit të fushave të veprimt, shumica e OSHC-ve që morën pjesë në fokus grupe ishin të përfshira në mënyrë aktive në

13 <https://www.parlament.al/transparenca/regjistri-elektronik/>

14 <http://www.amshc.gov.al/web/ojf/>

disa fusha, siç janë të drejtat e njeriut, barazia gjinore, rinia, mjedisi, media dhe bujqësia. Përveç kësaj, aktiviteti i OSHC-ve ekzistuese vendore është i bazuar në projekte dhe të orientuara sipas fushave të financimit të donatorëve, prandaj është e vështirë të përgatitet një hartë e qartë e fushave specifike të veprimit të këtyre OSHC-ve.

Lidhur me instrumentet aktuale të ndërtuara nga njësitë e qeverisjes vendore, është e rëndësishme të përmendet fakti se, si rezultat i reformës territoriale - administrative të ndërmarra nga Qeveria e Shqipërisë, të gjitha 61 bashkitë e sapo- krijuara janë ende në proces riorganizimi.<sup>15</sup> Ky proces është shoqëruar me ndryshime në legjislacionin që rregullon qeverisjen vendore dhe shumë bashki janë ende në procesin e miratimit të legjislacionit anti -korrupsion dhe instrumentet ligjore përkatëse. Kështu që, është ende shumë herët për të identifikuar dhe për të vlerësuar përvojën e njësive të qeverisjes vendore në anti-korrupsion.

---

<sup>15</sup> Ligji Nr. 115/2014: "Për ndarjen administrative-territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë".

### 3. VETËQEVERISJA VENDORE NË SHQIPËRI, POLITIKAT, KUADRI RREGULLATOR DHE STRUKTURAT E LUFTËS KUNDËR KORRUPSIONIT

Ky seksion paraqet një vlerësim të përgjithshëm mbi vetëqeverisjen vendore në Shqipëri dhe një vlerësim më të detajuar apo më të orientuar tek politikat, kuadri rregullator dhe strukturat e luftës kundër korrupsionit që Ligji përcakton për Vetëqeverisjen Vendore.

### 3.1 Përmbledhje e Përgjithshme Legjislative e NJQV-ve

Qeverisja vendore në tërësi buron nga Kushtetuta,<sup>16</sup> e cila disiplinon dhe përcakton parimet, nivelet e qeverisjes vendore, ngritjen dhe funksionimin e tyre, të drejtat dhe funksionet e organeve përfaqësuese. Në nenet 108-115 Kushtetuta ka përcaktuar se:

- Bashkia është njësi bazë e vetëqeverisjes vendore dhe Qarku është njësi e nivelit të dytë.
- Vetëqeverisja në njësitë vendore ushtrohet nëpërmjet organeve të tyre përfaqësuese dhe referendumeve vendore.
- Organet përfaqësuese të njësive të qeverisjes vendore janë këshillat, të cilët zgjidhen me zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë. Këshillat rregullojnë dhe administrojnë në mënyrë të pavarur çështjet vendore brenda juridiksionit të tyre.
- Organi ekzekutiv i bashkisë është Kryetari, i cili zgjidhet drejtpërdrejt nga populli.
- Karta Evropiane për Autonomi Vendore e ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1999 mbart detyrimin për implementimin e normave dhe standardeve evropiane për vetëqeverisjen në legjislacionin e brendshëm shqiptarë.
- Ligji “Për Vetëqeverisjen Vendore”<sup>17</sup> rregullon misionin e të drejtat e njësive të qeverisjes vendore, kompetencat dhe funksionet, burimet dhe shpenzimet, bashkëpunimin dhe bashkëveprimin me institucionet e tjera qeveritare. Vendi ka 61 bashki dhe 12 qarqe.<sup>18</sup>

### 3.2 Politikat, Kuadri Rregullator dhe Strukturat e Luftës kundër Korrupsionit

Lufta kundër korrupsionit është një proces dinamik, një betejë

16 Ligji Nr. 8471, date 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, miratuar me Referendum më 22 Nëntor 1998 dhe ndryshuar më 13 Janar 2007

17 Ligji Nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”

18 Ligji Nr. 115/2014 “Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”



e vazhdueshme e bazuar kryesisht dhe jo vetëm në krijimin dhe konsolidimin e parimeve të transparencës, pjesëmarrjes qytetare, përgjegjshmërisë dhe integritetit. Për këtë arsye raporti i vlerësimit për politikën, kuadrin rregullator dhe strukturat e luftës kundër korrupsionit do të përfshijë vlerësimin e parimeve të sipër cituara në rrafshin kombëtar dhe vendor.

### *3.2.1 Kuadri i Politikave të Luftës Kundër Korrupsionit*

Ekzistojnë disa dokumente strategjike që kanë formuluar politika, vendosur objektiva, synime e masa në fushën e luftës kundër korrupsionit.

Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020<sup>19</sup> dhe Plani i Veprimit kanë përfshirë në qëllimet madhore të tyre parandalimin, ndëshkimin dhe ndërgjegjësimin rreth korrupsionit. Në qasjen parandaluese parashikohen objektiva që në thelb përshijnë edhe synimet dhe objektivat e vetëqeverisjes vendore siç janë: (i) rritja e transparencës dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion (ii) fuqizimi i infrastrukturës elektronike (iii) forcimi i integritetit të nëpunësve publikë (iv) përdorimi sistematik i evidentimit të hapësirave për korrupsion. Në lidhje me rolin e shoqërisë civile, kjo strategji thekson se “është shumë e rëndësishme përfshirja e aktorëve të shoqërisë civile në procesin e konceptimit dhe çka është më e rëndësishme, mundësimi i saj për të monitoruar ecurinë në zbatimin e masave anti-korrupsion nga qeveria.”

Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020<sup>20</sup> paraqet vizionin e qeverisë për forcimin e qeverisjes dhe demokracisë vendore si dhe thellimin e procesit të decentralizimit. Strategjia megjithëse citon vetëm njëherë fjalën korrupsion, ajo në vetvete ka evidentuar katër qëllime strategjike. Strategjia citon se: “Parimet e qeverisjes së hapur, transparencës dhe llogaridhënies do të jenë parime të detyruara për t’u aplikuar nga njësitë e qeverisjes vendore me ndryshimet që do i bëhen Ligjit të ri organik të Qeverisjes Vendore....Llogaridhënia në nivel vendor do të nxitet edhe nëpërmjet zbatimit të sistemeve të menaxhimit

<sup>19</sup> Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 247, datë 20.03.2015

<sup>20</sup> Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 691, datë 29.07.2015

të performancës... Gjithashtu qeveria do të nxisë monitorimin e pavarur të strategjisë nëpërmjet mekanizmave dhe organizatave të shoqërisë civile apo partnerëve ndërkombëtarë.”

Rezoluta “Për Njohjen dhe Forcimin e Rolit të Shoqërisë Civile në Procesin e Zhvillimeve Demokratike të Vendit<sup>21</sup> vlerëson “Kontributin e dhënë nga shoqëria civile në drejtim të respektimit, promovimit të lirive dhe të drejtave të njeriut, forcimit të shtetit të së drejtës dhe të një shoqërie të drejtë, të hapur dhe demokratike në vendin tone...” angazhohet në “Nxitjen dhe mbështetjen e nismave që kanë si qëllim fuqizimin dhe promovimin e bashkëpunimit midis shoqërisë civile dhe institucioneve publike, në mënyrë të veçantë me njësitë e qeverisjes vendore, duke inkurajuar zhvillimin e një dialogu të hapur, konstruktiv dhe një klimë mirëbesimi mes tyre.”

### *3.2.2 Kuadri Rregullator i Luftës kundër Korrupsionit*

Ka një numër të madh aktesh që normojnë, rregullojnë dhe obligojnë institucionet publike, përfshirë vetëqeverisjen vendore të zbatojë parimet e sipër cituara në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet miratimit të rregulloreve apo krijimit të strukturave përkatëse. Analiza e akteve në vijim është bërë duke respektuar renditjen në hierarki të normave juridike.

### *3.2.3 Dokumente dhe Konventa Ndërkombëtare*

Karta Evropiane e Autonomisë Vendore<sup>22</sup> zë një vend të rëndësishëm dhe shërben si një model për zbatimin e normave dhe standardeve evropiane në legjislacionin e brendshëm. Karta parashton se vetëqeverisja efektive është thelbësore për demokracinë dhe vlerëson “se e drejta e qytetarëve për të marrë pjesë në drejtimin e çështjeve publike bën pjesë në parimet demokratike të përbashkëta për të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës”<sup>23</sup>. Protokollin shtesë i Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore për të

21 Miratuar nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë më 24.12.2014

22 Ligji Nr. 8548, datë 11.11.1999 Kuvendi i Shqipërisë ka ratifikuar “Kartën Evropiane të Autonomisë Vendore”.

23 [http://www.coe.int/t/congress/Texts/conventions/charte\\_autonomie\\_en.asp](http://www.coe.int/t/congress/Texts/conventions/charte_autonomie_en.asp)

drejtën për pjesëmarrje në punët e një organi vendor (CETS n° 207). Shqipëria nëpërmjet Këshillit të Ministrave ka miratuar në parim protokollin. Megjithatë, për arsye të panjohura, protokollin nuk ka kaluar në Kuvend për ratifikim. Për pasojë, Shqipëria nuk ka depozituar tek Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit.

Kodi i praktikës së mirë për pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes është një dokument i rëndësishëm, në të cilin përcaktohen parimet e përgjithshme, udhëzimet, instrumentet dhe mekanizmat për pjesëmarrje të qytetarëve. Shqipëria nuk ka adaptuar në nivel vendor një manual për zbatimin kodit të praktikës së mirë. Qeverisjes vendore i mungojnë praktikat ligjore që rregullojnë dialogun dhe partneritetin.

Shqipëria ka ratifikuar dy Konventa Ndërkombëtare: Konventën e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit<sup>24</sup> dhe Konventën Civile “Për Korrupsionin”.<sup>25</sup> Shqipëria ka marrë përsipër të marrë masa të përshtatshme për të nxitur pjesëmarrjen aktive të individëve dhe grupeve jashtë sektorit publik, siç është shoqëria civile, organizatat joqeveritare dhe organizatat e bazuara mbi komunitet, në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit. Masat e tjera synojnë të rritin ndërgjegjësimin publik në lidhje me ekzistencën, shkaqet, rëndësinë dhe kërcënimin që përbën korrupsioni.

### 3.2.4 Legjislacioni Kombëtar

Ligji “Për vetëqeverisjen vendore”<sup>26</sup> rregullon organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore në Shqipëri. Ai përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre e të organeve përkatëse. Në kapitullin VI, ligji rregullon transparencën, konsultimin dhe pjesëmarrjen qytetare. Sipas këtij kapitulli organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara:

- të garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre;
- të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes;

<sup>24</sup> Ratifikuar me Ligjin Nr. 9492, date 13.03.2006

<sup>25</sup> Ligji Nr. 8635, datë 06.07.2000 “Për ratifikimin e Konventës Civile për Korrupsionin”

<sup>26</sup> Ligji Nr. 139/2015, “Për vetë-qeverisjen vendore” miratuar më 12.17.2015

- të caktojnë koordinatorin e transparencës;
- të miratojnë programin e transparencës;
- të caktojnë koordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik;
- të publikojnë në faqen zyrtare të internetit çdo akt të organeve;
- të afishohen në vendet e caktuara për njoftimet publike aktet e organeve.

Këshilli i Bashkisë duhet të organizojë para shqyrtimit e miratimit të akteve këshillim me bashkësinë. Këshillimi është i detyrueshëm kur:

- miratohet rregullorja e brendshme e funksionimit të Këshillit të Bashkisë;
- miratohet buxheti dhe ndryshimet e tij;
- miratohet tjetërsimi ose dhënia në përdorim të pronave të tretëve;
- vendosen taksat e tarifave vendore;
- miratohen norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve si dhe për mbrojtjen e garantimit e interesit publik.

Në rregulloren e Këshillit të Bashkisë duhet të ketë norma që rregullojnë pjesëmarrjen e qytetarëve në mbledhjen e këshillit; mënyrën e këshillimit me bashkësinë; mënyrat dhe rregullat për informimin e publikut; mënyrat dhe forma e paraqitjes iniciativës qytetare si dhe procedurat për shqyrtimit dhe miratimit të tyre.

Ligji “Për të Drejtën e Informimit”<sup>27</sup> garanton njohjen e publikut me informacion, formimin e pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë, nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike. Në veprimtarinë e tyre organet e njësive të qeverisjes vendore si autoritete publike mbartin detyrimin e garantimit të së drejtës së informimit si detyrim kushtetues e ligjor dhe që siguron transparencën e tyre. Garantimi i kësaj të drejte realizohet nëpërmjet dy mënyrave të publikimit të informacionit, (i) me dhe (ii) pa kërkesë, për këtë ligji i sipërcituar ka detajuar rregullat, procedurat dhe strukturat përkatëse. Organet e njësive të qeverisjes vendore duhet të:

<sup>27</sup> Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i miratuar më 18.9.2014

- Përgatisin dhe të miratojnë programet e transparencës jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e ligjit<sup>28</sup> ose nga krijimi i tyre.
- Vënë në dispozicion të publikut nëpërmjet faqes së tyre në internet të 16 kategorive të informacionit në format lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme.
- Mbajnë dhe të bëjnë publik një regjistër të posaçëm “Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve” ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre.
- Caktojnë një prej nëpunësve si koordinator për të drejtën e informimit i cili bën bashkërendimin e punës për garantimin e së drejtës së informimit.

Ligji ka trajtuar dhe rregulluar formatin e “kërkesën për informim”, mënyrat e dërgimit, pranimit, regjistrimit dhe të saktësisht; koston e shërbimit; afatin për marrjen e informacionit; kufizimet e të drejtës së informacionit; kundërvajtjet administrative dhe sanksionet.

Ligji “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”<sup>29</sup> përcakton rregullat që duhen zbatuar për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse dhe synon nxitjen e transparencës, të përgjegjshmërisë dhe integritetit të autoriteteve publike. Për bashkërendimin dhe administrimin e përgjithshëm të punës për garantimin e së drejtës së njoftimit e të konsultimit publik organet e njësisve të qeverisjes vendore duhet të caktojnë një person si koordinator të njoftimit e konsultimit publik.

Ligji ka rregulluar procesin e:

- Njoftimit. Njoftimi për projekt-aktet bëhet nëpërmjet regjistrin elektronik por mund të përdoren edhe forma të tjera njoftimi (me postë elektronike, lajmërim publik, lajmërim në media, botime në gazeta, revista, etj.)
- Publikimit. Çdo projekt-akt publikohet në regjistrin elektronik për njoftimin dhe konsultimin publik. Regjistri është një faqe zyrtare interneti, e cila shërben si një pikë qendrore konsultimi. Regjistri ofron (i) për informim, printim dhe ripërdorim të dokumenteve të publikuara në të për të gjithë përdoruesit, grupet e interesit (ii)

28 Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i miratuar më 18.9.2014

29 Ligji Nr. 146/2014, “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” miratuar më 30.10.2014

programin e transparencës (iii) planet vjetore të organeve publike që lidhen me procesin e vendimmarrjes. Regjistri elektronik administrohet nëpërmjet faqes [www.konsultimipublik.gov.al](http://www.konsultimipublik.gov.al).<sup>30</sup>

- Konsultimit. Ligji parashikon dy forma të konsultimit publik: regjistri elektronik dhe takime publike të hapura.
- Marrja e komenteve dhe rekomandimeve. Koordinator i njoftimit dhe konsultimit publik grumbullon opinionet, komentet dhe rekomandimet e siguruar gjatë procesit të konsultimit.
- Raportet për transparencën në procesin e vendimmarrjes. Ligji parashikon që organet publike janë të detyruara të hartojnë dhe të publikojnë raporte vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes.

Ligji “Për Bashkëpunimin e Publikut në Luftën Kundër Korrupsionit”<sup>31</sup> ka si qëllimi të nxisë pjesëmarrjen e publikut në denoncimin e korrupsionit, duke mbrojtur e nxitur personat, të cilët denoncojnë praktikave korruptive të abuzimit me autoritetin publik (përfshirë autoritetet e vetëqeverisjes vendore). Ligji bën përcaktimin e rregullave dhe procedurave për denoncimin dhe regjistrimin e praktikave korruptive. Ligji përcakton rregullat e hollësishme për regjistrimin, dokumentimin, vlerësimin dhe transferimin e denoncimeve, të cilat përcaktohen në rregulloren e brendshme të çdo institucioni. Për denoncimin dhe regjistrimin e praktikave korruptive është krijuar një faqe unike online [www.stopkorrupsionit.al](http://www.stopkorrupsionit.al) Kjo faqe përqendron koordinimin dhe menaxhimin e praktikave korruptive të denoncuar në një faqe të vetme dhe lehtëson denoncimin nga çdo person i interesuar. Faqja funksionon në bazë të një rregulloreje të miratuar nga kryeministri.



### 3.3 Kuadri Rregullator Financiar

Analiza e kuadrit ligjor financiar është përqendruar në vlerësimin e procedurave për sa i përket transparencës, pjesëmarrjes publike dhe procedurave e anti-korrupsion që aplikohen nga njësitë vendore.

30 VKM Nr. 828, “Për Miratimin e Rregullores për Krijimin dhe Administrimin e Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike”, miratuar më 07.10.2015

31 Ligji Nr. 9508, datë 3.4.2006 “Për bashkëpunimin e publikut në luftën kundër korrupsionit”

Çështjet financiare të qeverisjes vendore rregullohen me një paketë të plotë ligjore ku në mënyrë të përmbledhur mund të përmendim Ligjin “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”<sup>32</sup>, Ligjin “Për inspektimin financiar publik”<sup>33</sup>, Ligjin “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”<sup>34</sup> dhe Ligjin “Për Menaxhimin dhe Kontrollin e Financave Publike”.

Korniza ligjore financiare *ka në vëmendje të veçantë transparencën e veprimeve dhe akteve të qeverisjes vendore*. Në këtë kontekst “Buxhetet e njësisve të qeverisjes vendore publikohen në Buletinin e Njoftimeve Publike përkatës 15 ditë pas miratimit”.<sup>35</sup> “Njoftimi për mbledhjen e këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, në të cilën do të shqyrtohet vendimi, duhet të botohet në një gazetë me tirazh të konsiderueshëm, jo më pak se pesëmbëdhjetë ditë para datës së mbledhjes. Njësia e qeverisjes vendore merr hua me vendim të këshillit për huamarrjen, të miratuar me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit, në një mbledhje të hapur për publikun”<sup>36</sup> “Të gjitha dokumentet e lidhura me huamarrjen vendore janë dokumente zyrtare dhe janë të lejueshme për publikun”. “Titullarët e njësisve kanë përgjegjësi për vendosjen e rregullave dhe procedura-ve për njoftimin, shqyrtimin, zbulimin dhe raportimin e dobësive administrative, mospërputhjeve dhe shkeljeve, që krijojnë terren për korrupsion, mashtrime, apo parregullsi.”<sup>37</sup>

Dokumentet që përcaktojnë kornizën e politikave për luftën kundër korrupsionit mund të përkufizohen si dokumente të cilat formulojnë politikën e integritetit Evropian të vendit dhe procesin e decentralizimit në Shqipëri. Për më tepër, dokumentet e sipër listuara inkurajojnë dhe krijojnë një mjedis të përshtatshëm legjislativ për të luftuar korrupsionin dhe për të mbështetur forcimin e rolit të shoqërisë civile. Kuadri ligjor shqyrtuar në pjesën e parë shërben si një bazë (ose udhëzues) për çështjet e ardhshme të analizuara në seksionet e mëposhtme.

32 Ligji Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”

33 Ligji Nr. 112/2015 “Për inspektimin financiar publik”

34 Ligji Nr. 9869, datë 4.2.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”

35 Neni 33 i Ligjit “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”

36 Neni 7 dhe 28 i Ligjit “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”

37 Manual për Menaxhimin dhe Kontrollin Financiar

## 4. INSTRUMENTET ANTI-KORRUPSION TË NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE


Ky seksion synon të vlerësojë instrumentet e NJQV-ve në luftën kundër korrupsionit të vendosura nga 20 bashkitë e përfshira në këtë raport.

Gjetjet kryesore tregojnë se njësitë e qeverisjes vendore nuk kanë miratuar pjesën më të madhe të masave anti-korrupsion që rrjedhin nga kuadri ligjor. Të pyeturit nga bashkitë kanë theksuar angazhimin e tyre për të krijuar këto instrumente/masa në të ardhmen e afërt. Për më tepër, ata e justifikojnë mungesën e këtyre instrumenteve me kohën e shkurtër të krijimit dhe ndryshimeve në organizim dhe funksionim si rezultat i reformës administrativo-territoriale dhe reformës së decentralizimit.

Grafiku i mëposhtëm paraqet bashkitë, të cilat kanë miratuar ose jo masat e anti-korrupsion.



Graph 1. LGUs Anti-Corruption Resources



**Programi i Transparencës:** Informacioni i marrë nga 20 bashki tregon se programi i transparencës është miratuar në 5 prej 20 bashkive (Bashkitë: Ura Vajgurore, Shijak,<sup>38</sup> Cërrik,<sup>39</sup> Librazhd,<sup>40</sup> and Vorë<sup>41</sup>). Të pyeturit në këto bashki, të cilat tashmë e kanë miratuar programin e transparencës kanë deklaruar se procesi për miratimin e programit të transparencës është kryer pa pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile.

Programi i transparencës nuk është miratuar nga bashkitë: Bulqizë, Klos, Belsh, Gramsh, Prrenjas, Lushnjë, Divjakë, Libohovë, Tepelenë, Memaliaj, Maliq, Devoll, Has, Vau i Dejës dhe Selenicë. Disa prej bashkive kanë theksuar se janë në proces të miratimit të një programi të tillë gjatë gjysmës së dytë të vitit 2016 (Bashkitë: Gramsh, Lushnjë, Tepelenë dhe Vau i Dejës).

**Koordinatori (Zyrë ose Person) për Transparencën/të Drejtën për Informim:** Lidhur me emërimin e koordinatorit (zyrë ose person) për transparencë dhe e drejtën për informim, 17 nga 20 bashki kanë dhënë një përgjigje pozitive (Bashkitë: Ura Vajgurore, Bulqizë, Shijak, Cërrik,<sup>42</sup> Gramsh, Librazhd, Prrenjas, Lushnjë, Divjakë,

38 Urdhër Nr. 1384, datë 12.10. 2015

39 Urdhër Nr. 94, datë 26.11.2015

40 Miratuar më 07.01.2016

41 <https://files.acrobat.com/a/preview/bda4d1d6-7b95-429a-9449-7522d39d6f73>

42 Personi përgjegjës: Zj. Arta Xhika

Libohovë, Tepelenë<sup>43</sup>, Memaliaj,<sup>44</sup> Devoll, Has, Vau i Dejës, Vorë<sup>45</sup> dhe Selenicë). Në një numër të konsiderueshëm bashkish funksioni i koordinatorit për transparencën/të drejtën e informimit kryhet nga specialisti/zyra e marrëdhënieve me publikun (Bashkitë: Bulqizës, Shijak, Tepelenë, Memaliaj). Në bashkitë e tjera, ky pozicion është kryer nga nëpunës të tjerë publikë që punojnë në bashki, siç është p.sh juristi i bashkisë (Bashkia Shijak) ose si një funksion shtesë i nënkryetarit të bashkisë (Bashkia Has).

Bashkitë Klos, Belsh dhe Maliq janë përgjigjur se ende nuk kanë një koordinator të tillë. Për shkak të mungesës së faqeve zyrtare të internetit të dhënat e kontaktit të koordinatorit për transparencën/të drejtën e informimit mungojnë në pjesën më të madhe të të gjitha bashkive të përfshira në projekt, me përjashtim të Bashkisë Vorë.<sup>46</sup>

**Regjistri Elektronik për Njoftimet/Konsultimet Publike:** Asnjë nga bashkitë e përfshira në projekt nuk ka krijuar një regjistrë elektronik për njoftimet/konsultimet publike. Disa nga bashkitë kanë deklaruar se janë në proces të përgatitjes së regjistrit elektronik (Bashkitë: Ura Vajgurore, Klos, Cërrik, Prrenjas, Libohovë, Selenicë, dhe Vorë).

Disa NJQV kanë miratuar mjete të tjera për njoftimet dhe konsultimet publike si, p.sh.:

- Publikimi i njoftimeve në vende publike të bashkisë ose nëpërmjet njoftimeve në mediat vendore (p.sh. Bashkitë Klos, Cërrik dhe Memaliaj);
- Përdorimi i adresës elektronike si një mjet komunikimi (Bashkia Belsh);
- Shpërndarja e njoftimeve (Bashkia Divjakë);
- Dëgjesa publike (Bashkitë: Ura Vajgurore dhe Memaliaj).

Përgatitja e regjistrit elektronik është një proces i lidhur ngushtë me faqen e internetit të bashkisë, e cila mungon në pothuajse të gjitha bashkitë e përfshira në projekt, me përjashtim të bashkive të

43 Personi përgjegjës: Mr. Aleksandër Toti

44 Personi përgjegjës: Ms. Matilda Sula

45 <http://bashkiavore.gov.al/sq-al/Services/Pages/Programitransparencesperbashkinevore.aspx>

46 Po aty.

Lushnjës<sup>47</sup> dhe Vorës.<sup>48</sup>

**Koordinatori për Njoftimin/Konsultimin Publik:** 10 nga 20 bashki janë përgjigjur pozitivisht në lidhje me pozicionin e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik brenda strukturës administrative të bashkisë (Bashkitë: Ura Vajgurore, Bulqizë, Klos, Cërrik,<sup>49</sup> Gramsh, Prrenjas, Lushnjë, Memaliaj,<sup>50</sup> Vau i Dejës, dhe Vorë).

Ashtu si edhe në rastin e koordinatorit për transparencë/të drejtën për informim, koordinatori për njoftimin/konsultimin publik është konsideruar shpesh një pozicion i ngjashëm dhe që kryhet nga specialisti/zyrapër marrëdhënie me publikun (p.sh. Bashkitë: Bulqizë, Gramsh, Lushnjë dhe Memaliaj). Rrjedhimisht, duhet të theksohet se në këto raste specialist i marrëdhënive me publikun është përgjegjës për të dy pozicionet: Koordinatorin për transparencën/të drejtën e informimit dhe koordinatorin për njoftimin/konsultimin publik. Në raste të tjera, funksioni i koordinatorit për njoftimin konsultimin/publik kryhet nga anëtarë të tjerë të stafit, p.sh. personat përgjegjës për këtë pozicion në Bashkinë Klos janë Nënkrjetari dhe Sekretari i Këshillit Bashkiak.

Bashkitë të cilat nuk kanë emëruar një koordinator për njoftimin/konsultimin publik janë bashkitë: Shijak, Belsh, Librazhd, Divjakë, Libohovë, Tepelenë, Maliq, Devoll, Has dhe Selenicë.

**Rregullore për raportimin e rasteve të korrupsionit:** 2 nga 20 bashki kanë përfshirë rregulla për regjistrimin, dokumentimin, vlerësimin dhe delegimin e rasteve të raportuara të korrupsionit brenda rregullores së brendshme të bashkisë (Tepelenë, Klos). Bashkia e Urës Vajgurore ka krijuar një numër falas (08007161), i cili synon të inkurajojë qytetarët të raportojnë rastet e korrupsionit të hasura me administratën e bashkisë. 18 bashki të tjera nuk kanë një rregullore të veçantë për raportimin e rasteve të korrupsionit. Përveç kësaj, bashkitë Divjakë, Memaliaj, Bulqizë, Cërrik dhe Vorë janë në proces të hartimit të një rregulloreje të tillë.

**Rregullore për shkeljet administrative:** Legjislacioni në fuqi përcakton se çdo bashki duhet të vendosë rregulla dhe sanksione për shkelje

47 [www.bashkialushnje.gov.al](http://www.bashkialushnje.gov.al)

48 [www.bashkiavore.gov.al](http://www.bashkiavore.gov.al)

49 Personi përgjegjës: Mr. Evis Bica

50 Personi përgjegjës: Ms. Matilda Sula

administrative. Këto rregullore duhet të përfshijnë rregulla dhe procedura për njoftimin, shqyrtimin dhe raportimin e mangësive, mospërputhjeve dhe shkeljeve administrative që krijojnë terren për korrupsion, mashtrim apo parregullsi. Tetë nga 20 bashkitë e përfshira në projekt (Bashkitë: Ura Vajguore, Klos, Cërrik, Gramsh, Prrenjas, Divjakë, Tepelenë dhe Vorë) kanë marrë masa për t'i miratuar këto rregulla në rregulloren e tyre të brendshme. 12 bashki të tjera (Bashkitë: Bulqizë, Shijak, Belsh, Librazhd, Lushnjë, Libohovë, Memaliaj, Maliq, Devoll, Has, Vau i Dejës dhe Selenicë) të pyetura në kuadër të këtij raporti janë përgjigjur negativisht për ekzistencën e kësaj rregulloreje.

**Strategji për Menaxhimin e Riskut të Brendshëm:** Njësitë e qeverisjes vendore duhet të hartojnë strategjinë e tyre për menaxhimin e riskut dhe ta përditësojnë atë të paktën çdo tre vjet. Kjo strategji duhet të hartohet nga koordinatori për menaxhimin e riskut ose një zyrtar tjetër i autorizuar i njësisë së qeverisjes vendore. Ministria e Financave ka publikuar Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin<sup>51</sup> dhe modelet përkatëse për të ndihmuar institucionet publike për përgatitjen e strategjisë. Vetëm 8 nga 20 bashkitë e intervistuar për këtë raport kanë thënë se kanë miratuar një strategji të tillë. Këto bashki janë: Ura Vajguore, Cërrik, Prrenjas, Lushnjë, Divjakë, Has, Vorë dhe Selenicë.

Nga 20 bashki, 12 nuk kanë një Strategji për Menaxhimin e Riskut të Brendshëm. Disa prej tyre, të tilla si Bulqizë dhe Memaliaj, ka deklaruar se janë në proces të miratimit të saj, ndërsa në bashki të tjera (Klos, Memaliaj) menaxhimi i riskut të brendshëm kryhet nga auditi i brendshëm.

**Norma që rregullojnë Procedurat e Iniciativës Qytetare:** Normat që rregullojnë procedurën e paraqitjes, shqyrtimit dhe miratimit të iniciativës qytetare janë të përcaktuara në ligjin "Për Vetëqeverisjen Vendore". Katërmëdhjetë nga 20 bashki kanë miratuar norma të tilla brenda rregullores së brendshme të bashkisë (Bashkitë: Ura Vajguore, Bulqizë, Klos, Cërrik, Gramsh, Prrenjas, Lushnjë, Divjakë, Libohovë, Devoll, Has, Vau i Dejës, Vorë dhe Selenicë). Nga ana tjetër bashkitë: Shijak, Belsh, Librazhd, Tepelenë, Memaliaj dhe Maliq nuk i kanë miratuar ende këto norma.

<sup>51</sup> Miratuar me Urdhër të Ministrisë së Financave. Nr. 8980, date 15.07.2010

**Kodi i Etikës/Sjelljes:** Bashkitë janë pyetur në lidhje me ekzistencën e Kodit të Etikës/Sjelljes për Këshillin Bashkiak dhe Administratën. Katërbëdhjetë nga 20 bashki konfirmuan që kanë të miratuar një kod të etikës/sjelljes. Nga këto bashki:

- Bashkia e Urës Vajgurore ka miratuar një kod etike për Këshillin Bashkiak dhe Administratën;
- Bashkitë: Librazhd, Prrenjas dhe Tepelenë e kanë përfshirë këtë kod në rregulloren e tyre të brendshme,
- Bashkitë: Belsh<sup>52</sup> dhe Lushnjë kanë miratuar Kodin e Etikës vetëm për administratën, por jo për Këshillin Bashkiak.

Pesë nga 20 bashki<sup>53</sup> nuk kanë një kod të tillë etike/sjellje (Bashkitë: Shijak, Cërrik, Memaliaj, Maliq, Has). Nga këto bashki:

- Bashkia e Memaliaj është në procesin e hartimit të këtij kodi;
- Disa bashki të tjera rregullojnë normat e etikës bazuar në mbështetje të ligjit “Për rregullat e etikës në administratën publike” (Bashkitë: Cërrik dhe Has).

**Strategjia kundër Korrupsionit:** Asnjë nga 20 bashkitë e përfshira në këtë projekt nuk ka miratuar një strategji kundër korrupsionit. Bashkitë: Bulqizë, Cërrik dhe Vorë janë përgjigjur se janë në procesin e hartimit të Strategjisë Kundër Korrupsionit.

**Rregulla të brendshme për mbledhjen e rregullt të të dhënave në lidhje me rreziqet e korrupsionit:** 2 nga 20 bashki kanë rregulla të brendshme për mbledhjen e rregullt të të dhënave në lidhje me rreziqet e korrupsionit (Bashkitë: Gramsh dhe Prrenjas<sup>54</sup>). Tetëmbëdhjetë nga 20 bashki (Ura Vajgurore, Bulqizës, Klos, Shijak, Cërrik, Belsh, Librazhd, Lushnjë, Divjakë, Libohovë, Tepelenë, Memaliaj, Maliq, Devoll, Has, Vau i Dejës, Vorë dhe Selenicë) nuk kanë rregulla të brendshme për mbledhjen e rregullt të të dhënave në lidhje me rreziqet e korrupsionit në nivel vendor. Përveç kësaj, ata nuk ndjekin një sistem të treguesve për monitorimin e rreziqeve të korrupsionit. Të njëjtat bashki nuk kanë udhëzime/manuale / trajnime për këtë çështje me përjashtim të bashkive: Gramsh, Divjakë dhe Prrenjas.

52 Urdhër i Brendshëm Nr. 138, date 13.10.2015.

53 Duke përjashtuar Bashkinë Bulqizë, e cila nuk i është përgjigjur kësaj pyetje.

54 Rregullore e Brendshme e Bashkisë

Këto bashki përdorin forma të tjera për mbledhjen e të dhënave në lidhje me korrupsionin, duke përfshirë:

- Raportimin e rasteve të korrupsionit pranë zyrave të bashkisë (Bashkia Belsh);
- Formulimin dhe përfshirjen e deklaratave të veçanta në kuadër të rregullores përkatëse të brendshme (Bashkia Prrenjas),
- Përdorimin e akteve të tjera ligjore, si psh. Manuali i Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (Bashkia Memaliaj),
- Auditimin e brendshëm (Bashkia Has);
- Ndërmarrja e procesit të miratimit të rregullave të tilla (Bashkia Vorë).

**Rregulla për mbrojtjen e bilbilfryrësve:** 18 nga 20 bashkitë e përfshira (Ura Vajgurore, Bulqizë, Klos, Shijak, Cërrik, Belsh, Gramsh, Librazhd, Lushnjë, Libohovë, Tepelenë, Memaliaj, Maliq, Devoll, Has, Vau i Dejës, Vorë dhe Selenicë) nuk kanë miratuar rregulla për mbrojtjen e bilbilfryrësve dhe dy prej këtyre bashkive (Bashkitë: Bulqizë dhe Vorë) deklaruan se ishin në procesin të miratimit të këtyre masave bazuar në legjislacionin përkatës.<sup>55</sup> Bashkitë Prrenjas dhe Divjakë nuk i janë përgjigj kësaj pyetjeje.

<sup>55</sup> Ligji “Për Procedurat Administrative” dhe akte të tjera ligjore në fuqi

## 5. NIVELI I AKTIVIZIMIT DHE KAPACITETEVE TË ORGANIZATAVE VENDORE TË SHOQËRISË CIVILE NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

Pjesëmarrja aktive e shoqërisë civile në mirë-qeverisje në nivel vendor, ende përbën një sfidë. Kapitulli në vijim synon të analizojë nivelin aktual të bashkëpunimit të njësive të qeverisjes vendore dhe organizatave vendore të shoqërisë civile. Gjithashtu, ky kapitull ka për qëllim identifikimin e pengesave kryesore dhe mundësive që ndikojnë në angazhimin aktiv të OSHC-ve vendore për të promovuar integritetin dhe luftën kundër korrupsionit në 20 bashkitë e vogla dhe të mesme të vendit.

Studimet e ndryshme kanë treguar se pavarësisht kapaciteteve dhe burimeve financiare të limituara, OSHC-të gradualisht kanë filluar të fokusojnë punën e tyre në çështjet e llogaridhënies, korrupsionit dhe buxhetimit në nivel vendor.<sup>56</sup> Pavarësisht progresit të bërë gjatë dy dekadave të fundit, organizatat e shoqërisë civile ende hasin vështirësi sa i takon rolit që ato duhet të luajnë si ura komunikimi ndërmjet qeverisjes vendore dhe qytetarëve. Ligji i ri “Për vetëqeverisjen vendore”, krahasuar me ligjin e mëparshëm “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, udhëhiqet nga një vizion i ri në lidhje me angazhimin qytetar,<sup>57</sup> ku aspekte të reja përcaktohen në kapitullin IV të këtij ligji, specifikisht në nenet për të drejtën për angazhimin qytetar,<sup>58</sup> neni për të drejtën për kërkesës, ankimimit, dhe vërejtjeve<sup>59</sup> në Kreun IV për “Transparencën, Konsultimet dhe Angazhimin Qytetar”.

## 5.1 Njohuritë dhe kapacitetet e OSHC-ve në luftën kundër korrupsionit në nivel vendor

Në bashkitë e vogla dhe të mesme të vendit vërehet nivel mjaft i ulët i angazhimit të OSHC-ve. Pjesëmarrësit në fokus grupet e realizuara në kuadër të këtij raporti theksojnë se ky angazhim kaq i ulët ka ulur jo vetëm besimin e grupeve të interesit dhe komunitetit në tërësi ndaj organizatave vendore të shoqërisë civile, por edhe ka krijuar “apati” ndërmjet vetë OSHC-ve për të ndërmarrë nisma të cilat lidhen veçanërisht me qeverisjen vendore dhe anti-korrupsionin. Puna e këtyre organizatave është kryesisht e bazuar në projekte dhe si e tillë, edhe fokusi i misionit dhe fushat e nismave të tyre janë të orientuara nga kërkesat e donatorëve. Në këtë kontekst, edhe nismat në fushën e anti-korrupsionit dhe mirëqeverisjes deri më tani janë ndërmarrë në sajë të kërkesave të donatorëve ndërkombëtarë. Përfaqësuesit e organizatave vendore pjesëmarrëse në takime kanë treguar njohuri dhe informacione bazë mbi mirëqeverisjen dhe të drejtat e tyre kryesisht në lidhje me pjesëmarrjen në mbledhjet e

56 “Anticorruption reloaded” - Assessment of Southeast Europe, Southeast Europe Leadership for Development and Integrity (SELDI), 2014

57 Ligji Nr.. 8652, datë 31.07.2000

58 Neni 20- “Për vetëqeverisjen vendore”, 2015

59 Neni 19- “Për vetëqeverisjen vendore”, 2015



këshillave bashkiakë-njohuri këto të cilat gjithashtu janë përftuar në sajë të fushatave ndërgjegjësuese apo projekteve sporadike në të kaluarën.

Gjatë diskutimeve mbi çështje më specifike në lidhje me ligjin e Vetëqeverisjes Vendore, pjesëmarrësit në këto takime janë shprehur se nuk kanë aspak njohuri mbi ekzistencën e instrumenteve ligjore specifike, të cilat përcaktojnë dhe nxisin pjesëmarrjen qytetare në qeverisjen vendore. Përfaqësuesit e OSHC-ve nuk kanë informacion mbi rregulloren e cila duhet të hartohet nga vetë bashkitë për tu mundësuar qytetarëve komunikim të vazhdueshëm me qëllim sigurimin e transparencës së punës së bashkisë. Gjithashtu, OSHC-të vendore nuk kanë dijeni mbi strukturat dhe mekanizmat anti-korrupsion që duhet të ngrihen nga NJQV-të. Ndërsa, në lidhje me mundësitë e bashkëpunimit dhe mekanizmat e duhur bashkëpunues me qytetarët dhe OSHC-të, që vetë bashkitë duhet të ngrejné, pjesa më e madhe e pjesëmarrësve theksojnë se “edhe nëse ka ndonjë iniciativë të ngjashme nga vetë ana e bashkive, ajo është thjesht formale”. Në përgjithësi, mungesa e informacionit vërehet dhe pohohet nga të gjithë pjesëmarrësit në fokus grupe duke shtuar se “Organizatat lokale të shoqërisë civile nuk kanë asnjë kontakt me administratën vendore qysh nga krijimi i bashkive të reja”.

Organizatrat vendore të shoqërisë civile në bashkitë e vogla dhe të mesme të vendit hasin vështirësi sa i përket kapaciteteve profesionale të organizatës për monitorimin e performancës dhe punës së bashkive në kuadër të mirë-qeverisjes dhe luftës ndaj korrupsionit. Ndërmjet pjesëmarrësve të OSHC-ve, të pyetur se sa mendojnë ata që janë në gjendje për tu angazhuar në nisma monitoruese të punës së bashkive, vetëm 1-2 OSHC konfirmojné që disponojné kapacitetet e duhura njerëzore profesionale. Pothuajse të gjitha OSHC-të e kontaktuara konfirmojné se organizatat e duhura disponojné kapacitete njerëzore, por më shumë se gjysma e tyre theksojnë se personat e angazhuar në organizata nuk kanë përgatitjen e duhur për tu përfshirë në nisma që kanë të bëjnë me luftën kundër korrupsionit dhe mirë-qeverisjen. Ky pohim është më i dukshëm tek organizatat e shoqërisë civile të cilat punojné në bashkitë e Bulqizës, Tepelenës, Memaliajt, Belshit, Devollit, Gramshit dhe Hasit. Ndërkohë që OSHC-të të cilat punojné në bashkitë e

Lushnjës, Librazhdit dhe Urën Vajgurore shfaqën eksperiencën dhe praktika më të mira gjatë punës së tyre në të kaluarën.

Përveç mangësive në informacion, pjesëmarrësit në takimet e organizuara në kuadër të këtij raporti kanë listuar një sërë ndërhyrjesh të cilat ata mendojnë se duhet të jenë pjesë e rëndësishme e punës së tyre, si për shembull nismat për rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe “presioni” ndaj administratave të njësive të qeverisjes vendore për të rritur përpjekjet në luftën kundër korrupsionit. Përfaqësuesit e OSHC-ve veçojnë të rinjtë si një nga aktorët më të rëndësishëm të cilët mund dhe duhet të çojnë përpara punën e shoqërisë civile në nivel vendor. Disa nga sugjerimet e përfutuara nga pjesëmarrësit për nisma të cilat do të shërbenin në rritjen e informacionit ndërmjet qytetarëve dhe që do të lehtësonin komunikimin ndërmjet OSHC-ve/ qytetarëve dhe institucioneve të qeverisjes vendore listohen si më poshtë:

- Pjesëmarrja e vazhdueshme në mbledhjet e Këshillave Bashkiakë
- Zhvillimi/ofrimi i trajnimeve për administratën e institucioneve të pushtetit vendor mbi çështjet e transparencës, llogaridhënies dhe integritetit.
- Organizimi i takimeve informuese dhe diskutimi me qytetarët, veçanërisht të rinjtë dhe nxënësit e shkollave të mesme.
- Publikimi paraprak (në mediat vendore) i rendit të ditës së mbledhjeve të Këshillave Bashkiakë. Ky publikim do të shërbejë për rritjen e informacionit ndërmjet qytetarëve mbi çështjet e diskutuara në mbledhjet e këshillave bashkiakë dhe sugjerohet nga OSHC-të si një masë jo-shtypëse që do të shërbejë për rritjen e kontrollit qytetar dhe transparencës së punës së bashkisë.
- Fushata ndërgjegjësuëse (nëpërmjet përdorimit të fletëpalosjeve, posterave, videove), me qëllim rritjen e kuptueshmërisë dhe përgjegjësisë qytetare në lidhje me rolin që ata kanë në mirë-qeverisje.
- Hartimi dhe analizimi i herëpashershëm i anketave si dhe përgatitja e studimeve të bazuara në të dhëna, me qëllim hartimin e rekomandimeve konkrete për këshillat bashkiakë.

Nën të njëjtën qasje, edhe të intervistuarit e bashkive të synuara

në projekt janë pyetur mbi nismat që ata vetë duhet të ndërmarrin. Informuesit kyç kanë pohuar rolin e rëndësishëm që NJQV-të duhet të luajnë në kuadër të rritjes së transparencës dhe cilësojnë këto të fundit si aktorë kyç që mund të ndihmojnë dhe vetë OSHC-të vendore për tu përfshirë në nisma që kanë të bëjnë me nxitjen e nismave në fushën e luftës kundër korrupsionit dhe mirë-qeverisjes. Ata theksojnë gjithashtu se NJQV-të nevojitet që të rrisin dhe zhvillojnë kapacitetet e tyre në kuadër të parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit si dhe në nxitjen e angazhimit qytetar.

## 5.2 Vështirësi dhe sfida

Kur flitet për nevojat dhe sfidat me të cilat përballen organizatat e shoqërisë civile që punojnë në bashkitë e vogla dhe të mesme të vendit, nevoja më emergjente që vërehet është rritja e kapaciteteve të këtyre organizatave në përputhje me misionin që ato kanë si dhe mbi çështjet që lidhen me mirë-qeverisjen. Në këtë raport, i cili shërben edhe si vlerësim paraprak i nevojave, OSHC-të theksojnë nevojën që ata kanë për trajnim në ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve të tyre në hartimin, zhvillimin dhe zbatimin e projekteve. OSHC-të gjithashtu theksojnë si mjaft të rëndësishme nevojën për trajnim mbi kuadrin legjislativ aktual në luftën kundër korrupsionit dhe qeverisjen vendore. OSHC-të theksojnë si ndërhyrjen e tretë

gjithashtu mjaft të rëndësishme atë të rritjes së kapacitetet në lobim, monitorimin dhe advokim.

### Kutiza 1. Pengesat e OSHC-ve në nivel vendor

- Mungesa e kapaciteteve organizative e zhvillimore
- Mungesa e financimeve dhe qëndrueshmërisë
- Mungesa e motivimit
- Mungesa e bashkëpunimit mes OSHC-ve e NJQV-ve
- Mungesa e vullnetit për rrjetëzim mes OSHC-ve

Pavarësisht nevojave, sfida kryesore e OSHC-ve mbetet financimi duke theksuar se mbeten të pafinancuara nga donatorët pikërisht për arsyen që janë organizata të vogla. Në këtë kuadër, ata kërkojnë mbështetje më të madhe nga komuniteti i donatorëve dhe “decentralizim” të fondeve

duke i shpërndarë ato nga organizatat që punojnë në bashkitë e mëdha tek organizatat vendore të shoqërisë civile.

Mungesa e besimit të qytetarëve në punën e institucioneve të qeverisjes vendore dhe në punën e funksionimit të vetë organizatave të shoqërisë civile përbën një nga problemet që hasen në kontekstet e bashkive të vogla e të mesme të vendit. Faktorët të cilët kanë ndikuar pikërisht në uljen e këtij besimi është mungesa e projekteve të vazhdueshme të OSHC-ve duke bërë që këto të fundit të mos jenë gjithmonë të pranishme në jetën e komunitetit. Pjesëmarrësit shtojnë gjithashtu që puna individuale e organizatave, duke mos krijuar rrjete dhe me organizata e tjera si dhe mungesa e vullnetarizmit janë dy faktorë gjithashtu të rëndësishëm në zbutjen e rolit të organizatave vendore të shoqërisë civile në kontekstin vendor.

Në kuadër të nivelit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të qeverisjes vendore dhe OSHC-ve, pjesëmarrësit e lidhin ngushtësisht suksesin apo dështimin e këtij bashkëpunimi me kryetarin e bashkisë. Ata theksojnë se hendeku i komunikimit ndërmjet këtyre dy aktorëve është duke u theksuar gjithmonë nga viti në vit. Pjesëmarrësit e cilësojnë bashkëpunimin ndërmjet OSHC-ve dhe NJQV-ve si një faktor kritik i cili ndikon në qëndrueshmërinë dhe të ardhmen e sektorit të shoqërisë civile dhe të zhvillimit të shoqërisë në tërësi. Ata gjithashtu mendojnë se mungesa e kapaciteteve profesionale dhe mungesa e interesit nga vetë aktorët janë dy faktorë të cilët ndikojnë në krijimin e këtij ngërçi komunikimi.

## 6. NIVELI I KORRUPSIONIT NË NJËSITË E QEVERISJES VENDORE: PERCEPTIME TË ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE

Në kuadër të kapaciteteve që zotërojnë institucionet e qeverisjes vendore dhe ekspozimit të tyre ndaj korrupsionit, përfaqësuesit e organizatave vendore të shoqërisë civile kanë ofruar disa sugjerime konkrete mbi nevojat e sektorëve specifikë, pavarësisht nivelit të tyre të ulët të pjesëmarrjes në mirëqeverisje dhe vendimmarrje. Reforma e re territoriale u përcaktor përgjegjësi të reja dhe më të mëdha sistemit të qeverisjes vendore. Në këtë kuadër, ato duhet të ngrenë mekanizma të qëndrueshëm dhe të dukshëm për parandalimin, luftimin e korrupsionit si dhe për të nxitur integritetin

e administratës së tyre, nëpërmjet rritjes së cilësisë së shërbimeve që ata ofrojnë për komunitetin. Këto mekanizma duhet të hartohen në përputhje me strategjinë Kombëtare Anti-korrupsion dhe Planin e saj të Veprimit.

Përpjekje dhe nisma të tilla në nivel vendor duhet të ndërmerren nëpërmjet një qasjeje të hapur dhe gjithëpërfshirëse. Perceptimet e pjesëmarrësve të OSHC-ve vendore mbi nivelin e ekspozimit ndaj korrupsionit të sektorëve të veçantë të bashkive përkatëse vjen më së shumti nga eksperiencat e tyre si qytetarë apo të të afërmve të tyre në raste specifike kur u është dashur të marrin shërbime të caktuara nga sektorë/zyra në bashkitë përkatëse.

Mungesa e profesionalizmit të administratës së institucioneve të qeverisjes vendore, si një nga pengesat kryesore për krijimin e një qeverisjeje vendore të hapur dhe transparente është pohuar nga të gjithë pjesëmarrësit. Ajo çka vlen për tu theksuar gjithashtu në këtë raport vlerësimi është mungesa e informacionit të OSHC-ve vendore mbi strukturat dhe funksionimin e brendshëm të bashkive.

Perceptimi i nevojave për trajnim sipas sektorëve: Të intervistuarit vlerësuan se sektorët brenda institucioneve vendore të cilat duhet të trajnohen menjëherë në lidhje me kuadrin ligjor për anti-korrupsion dhe qeverisjes vendore janë:

- Zyra e Urbanistikës
- Zyra për Marrëdhëniet me Publikun dhe e Informacionit
- Zyra e Bujqësisë
- Ndërmarrjet e shërbimeve publike
- Zyra e Financës
- Zyra e Teknologjisë së informacionit për të rritur transparencën dhe përhapjen e informacionit për aktivitetet e bashkisë
- Zyra e Prokurimeve
- Zyra e Ndihmës Sociale

Pjesëmarrësit nga Bulqiza, Hasi, Tepelena, dhe Devolli mendojnë se media është një aktor i rëndësishëm që duhet vlerësuar përmes trajnimeve. Bashkëpunimi i ngushtë me median do të rrisë

pjesëmarrjen qytetare dhe nxisë bashkinë të bashkëpunojë me OSHC-të vendore në mënyrë që të bëjë të mundur rritjen e llogaridhënies dhe transparencës. Po ashtu, ata theksuan se trajnimet me mediat duhet të fokusohen në kuadrin ligjor kundër korrupsionit, për qeverisjen vendore, si dhe ngritjen e kapaciteteve për çështje të qeverisjes së mirë.

Në të njëjtën linjë, OSHC-të e lidhin mungesën e profesionalizmit me nivelin e lartë të korrupsionit. Të pyetur në lidhje me departamentet e bashkisë/fushat e politikave me rrezik më të lartë korrupsioni, të anketuarit listuan të njëjtët sektorët/zyra të njësive të qeverisjes vendore të përmendura më lart në lidhje me kapacitetet e tyre profesionale dhe evidentuan nevojën për trajnime për kuadrin ligjor për qeverisjen vendore, integritetin e administratës dhe instrumentet përkatëse që duhet të zbatohen në kuadër të luftës kundër korrupsionit.

- Zyra e Urbanistikës
- Zyra për Marrëdhëniet me Publikun dhe e Informacionit
- Zyra e Bujqësisë
- Ndërmarrjet e shërbimeve publike
- Zyra e Financës
- Zyra e Teknologjisë së informacionit për të rritur transparencën dhe përhapjen e informacionit për aktivitetet e bashkisë
- Zyra e Prokurimeve
- Zyra e Ndhmës Sociale

## 7. ORGANIZATAT VENDORE TË SHOQËRISË CIVILE DHE NJËSITË E QEVERISJES VENDORE - DREJT NJË QASJEJE TË PËRBASHKËT

Ky raport ka për qëllim të identifikojë nivelin e angazhimit të OSHC-ve dhe NJQV-ve drejt një bashkëpunim pozitiv dhe të nxjerrë rekomandime nga të dy aktorët për ndërhyrje në të ardhmen. Të pyeturit nga 20 bashki kanë treguar përkushtim për të bashkëpunuar me organizatat vendore të shoqërisë civile në Projektin CIVILISC dhe iniciativa të tjera.



Sipas NJQV-ve, trajnimi mbetet një nga fushat më të rëndësishme që do të ndihmonte OSHC-të për t'u angazhuar në nisma në kuadër të luftës kundër korrupsionit.

I njëjti pohim është theksuar edhe nga përfaqësuesit e OSHC-ve lidhur me administrimin e institucioneve të qeverisjes vendore.

*Figura 1: Fushat në të cilat do të ofrohet mbështetje për organizatat e shoqërisë civile (në formën e trajnimit apo të tjera), në mënyrë që të rrisin kapacitetet e tyre për të përmirësuar qeverisjen e mirë dhe integritetin në institucionin e pushtetit vendor*

Ngritja e kapaciteteve dhe trajnimeve	Teknologjia e informacionit	Informacioni dhe transparencja	Raportimi i rasteve të korrupsionit
Buxhetimi me pjesëmarrje	Trajnime për legjislacionin anti-korrupsion	Dhuna në familje	Shërbimet publike
Zhvillimi ekonomik	Mbrojtja e mjedisit	Planifikimi urban	Rrjetëzimi, advokimi dhe monitorimi

Dy tabelat e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje të (i) fushave më të rëndësishme të rekomanduara nga njësitë e qeverisjes vendore, në të cilat OSHC-të mund të ndihmohen për të rritur kapacitetin dhe veprimet e tyre dhe (ii) rekomandimet e sugjeruara nga OSHC-të lidhur me ndërhyrjet imediate/të ardhshme që do të ndërmerren nga njësitë e qeverisjes vendore.

*Tabela 1: Rekomandime për Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të) në Promovimin e Qeverisjes së Mirë dhe Luftën Kundër Korrupsionit*

Bashkia	Rekomandime për veprime nga OSHC
Ura Vajgurore	<ul style="list-style-type: none"> <li>Hartimi i një strategjie të përbashkët të Veprimit në nivel bashkie</li> <li>Ndërmarrja e monitorimit të veprimeve lidhur me performancën dhe punën e njësisë së qeverisjes vendore.</li> <li>Rritja e ndërgjegjësimit dhe forcimi i bashkëpunimit me median dhe aktorë të tjerë në komunitetet vendore</li> </ul>

Bashkia	Rekomandime për veprime nga OSHC
Bulqizë	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zbatimi i veprimeve për të përmirësuar informimin dhe transparencën e fondeve publike</li> <li>Hartimi i një plani të përbashkët veprimi në luftën kundër korrupsionit mes NJQV-ve dhe OSHC-ve</li> <li>Rritja e kapaciteteve organizative dhe njerëzore të cilat ndihmojnë organizatat për të punuar në mënyrë profesionale dhe për t'u përqendruar në çështjet e transparencës dhe llogaridhënies</li> </ul>
Klos	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rritja e informacionit mes OSHC-ve në lidhje me motivet për korrupsion</li> <li>OSHC-të rrisin pjesëmarrjen e tyre në mbledhje këshillimi, sidomos për çështje të buxhetimit</li> <li>OSHC-të ofrojnë trajnime për administratën vendore për çështje të caktuara si: mjete për luftën kundër korrupsionit, kodi i etikës.</li> <li>OSHC-të zhvillojnë fushata për rritjen e ndërgjegjësimit lidhur me çështje të mirëqeverisjes vendore duke përdorur fletëpalosje dhe broshura si mjete të shpërndarjes së informacionit.</li> </ul>
Shijak	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndërmarrja e fushatave ndërgjegjësuese me qytetarët, me qëllim inkurajimin e tyre për raportimin e rasteve të korrupsionit.</li> </ul>
Cërrik	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rritja e bashkëpunimit mes OSHC-ve dhe qytetarëve në hartimin e strategjive vendore në luftën kundër korrupsionit.</li> <li>Rritja e kapaciteteve dhe e mbështetjes për OSHC-të vendore në promovimin e qeverisjes së mirë dhe luftën kundër praktikave korruptive.</li> <li>Hartimi i një programi vjetor me aktivitete të përbashkëta mes NJQV-ve dhe OSHC-ve dhe kryerjen e dëgjimeve publike në këtë proces.</li> <li>OSHC-të ofrojnë trajnime për administratën vendore në lidhje me çështje qeverisjes së mirë.</li> </ul>
Belsh	<ul style="list-style-type: none"> <li>OSHC-të duhet të jenë më aktive dhe të ofrojnë trajnime për administratën vendore për këtë çështje</li> </ul>
Librazhd	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rritja e veprimeve të OSHC-ve në monitorimin, trajnime për administratës vendore dhe rritjen e ndërgjegjësimit</li> </ul>
Prrrenjas	<ul style="list-style-type: none"> <li>OSHC-të kryejë çdo veprime në lidhje me transparencën dhe qeverisjen e mirë</li> </ul>
Lushnje	<ul style="list-style-type: none"> <li>OSHC-të ndërmarrin veprime lidhur me çështjet të transparencës dhe informimit publik</li> </ul>

Bashkia	Rekomandime për veprime nga OSHC
Divjakë	<ul style="list-style-type: none"> <li>OSHC ndërmarrin nisma për të identifikuar dhe raportuar rastet e korrupsionit nga ana e administratës vendore</li> </ul>
Libohovë	<ul style="list-style-type: none"> <li>Raportimi i çdo veprimi që shkel dispozitat dhe parimet ligjore.</li> <li>Rritja e bashkëpunimit me njësitë e qeverisjes vendore, ndërmarrjen e fushatave të ndërgjegjësimit me qytetarët lidhur me çështje të transparencës.</li> </ul>
Tepelenë	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rritja e pjesëmarrjes së OSHC-ve në takimet konsultative me NJQV-në</li> </ul>
Memaliaj	<ul style="list-style-type: none"> <li>OSHC-të kryejnë trajnime për administratën vendore dhe ndërtojnë komunikim të rregullt me të</li> </ul>
Devoll	<p>OSHC-të ndërmarrin veprime për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Rritjen e raportimit të rasteve të korrupsionit dhe vullnetarizmit të qytetarëve</li> <li>Rritjen e pjesëmarrjes në dëgjesat publike dhe konsultimet në lidhje me projekt vendimet e bashkisë</li> </ul>
Has	<ul style="list-style-type: none"> <li>OSHC-të rrisin bashkëpunimin me bashkinë duke përmirësuar transparencën në të gjitha veprimet e administrimit dhe menaxhimit të fondeve dhe shërbimeve publike</li> </ul>
Vau i Dejës	<ul style="list-style-type: none"> <li>Organizimi i mbledhjeve të hapura dhe të shpeshta me publikun në lidhje me rolin e shoqërisë civile dhe qytetarëve për të luftuar korrupsionin</li> </ul>
Vorë	<ul style="list-style-type: none"> <li>Veprime dhe fushata ndërgjegjësuere për të rritur raportimin e rasteve të korrupsionit</li> <li>OSHC-të forcojnë pavarësinë e tyre, krijimi i rrjeteve mes OSHC-të të tjera në nivel vendor.</li> <li>OSHC-të përqendrojnë misionin e tyre në drejtim të transparencës dhe inkurajimit të administratës vendore për ndërmarrjen e veprimeve në lidhje me këtë çështje dhe për të përmirësuar teknologjinë e informacionit.</li> </ul>
Selenicë	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mbështetje OSHC-ve për të rritur pjesëmarrjen dhe zbatuar projekte që fokusohen në-qeverisjen e mirë.</li> <li>Rritja e ndërgjegjësimit për raportimin e rasteve të korrupsionit</li> <li>Ofrimi i trajnimeve për administratën vendore mbi transparencën dhe integritetin</li> <li>Rritja e bashkëpunimit mes OSHC-ve dhe bashkisë dhe për të inkurajuar shkëmbimin e rregullt të informacionit</li> <li>OSHC-të hartojnë rekomandime konkrete për t'u shqyrtuar nga bashkia.</li> </ul>

## 8. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Ky raport arriti në përfundime të caktuara në lidhje me mjedisin ligjor mbi luftën kundër korrupsionit, nivelin e instrumenteve anti-korrupsion të ngritura nga njësitë e qeverisjes vendore për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin në nivel vendor si dhe nivelin e përgatitjes së organizatave vendore të shoqërisë civile për të vepruar në komunitetin e tyre vendor me qëllim nxitjen e qeverisjes së mirë.

Analiza e politikave, kuadrit rregullator dhe strukturave mundëson një mjedis pozitiv në lidhje me luftën kundër korrupsionit në nivel kombëtar dhe vendor. Megjithatë, zbatimi i legjislacionit ekzistues mbetet një sfidë, sidomos në lidhje me krijimin e mekanizmave të veçanta të kontrollit për të frenuar korrupsionin dhe përmirësuar angazhimin qytetar në nivel bashkiak.

Shqipëria nuk ka ratifikuar ende Protokollin Shtesë, i cilat plotëson tekstin e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Vendore “E drejta për të marrë pjesë në punët e një autoriteti vendor nënkupton të drejtën për të kërkuar, përcaktuar ose ndikuar në ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësi të një autoriteti vendore ... Protokollin gjithashtu

kërkon marrjen e masave, të cilat janë të nevojshme për të siguruar që integriteti etik dhe transparencja e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësi të organeve vendore nuk rrezikohet nga ushtrimi i së drejtës për të marrë pjesë...”<sup>60</sup>

Njësitë e qeverisjes vendore kërkojnë praktika ligjore që rregullojnë dialogun dhe partneritetin në proceset e vendim-marrjes. Përveç kësaj, duhet të zhvillohet manuali ligjor për zbatimin e kodit të praktikave të mira për pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendim-marrjes.

Bashkitë e vogla/të mesme, veçanërisht ato të sapokrijuara, janë ende në procesin e riorganizimit pas reformës së re territoriale dhe strategjisë së decentralizimit. Për këtë arsye, lufta kundër korrupsionit është konsideruar si një sfidë në drejtim të krijimit të një sistemi kontrolli për anti-korrupsionin dhe krijimin e një administrate profesionale. OSHC-të vendore në bashkitë e vogla/të mesme janë shumë të pakta ose inekzistente. Organizatat ekzistuese vendore të shoqërisë civile përballen me vështirësi që lidhen me kapacitetet e tyre organizative. Megjithatë, financimi mbetet shqetësimi kryesor i tyre, i cili kufizon frekuencën e aktivitetit të OSHC-ve dhe “e drejton” fokusin e ndërhyrjeve të tyre. Megjithatë, pavarësisht nga pengesat dhe sfidat me të cilat përballen në bashkinë e tyre përkatëse, OSHC-të vendore duhet të fokusohen në luftën kundër korrupsionit, rritjen e njohurive dhe kapaciteteve të tyre për monitorimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit për qeverisjen e mirë.

Gjetjet kryesore të këtij raporti në lidhje me përpjekjet e NJQV-ve për të luftuar korrupsionin dalin në përfundimin se institucionet e qeverisjes vendore nuk kanë kapacitete të mjaftueshme profesionale për të ushtruar autoritetin e tyre dhe për të zbatuar legjisllacionin në fuqi. Si pasojë, NJQV-të, sidomos sektorë të veçantë brenda bashkisë, duhet të rrisin transparencën, efikasitetin dhe gjithëpërfshirjen. Nga ana tjetër, angazhimi qytetar në luftën kundër korrupsionit është një domosdoshmëri dhe duhet të përmirësohet. OSHC-të duhet të përqendrojnë aktivitetet e tyre në drejtim të monitorimit të progresit në zbatimin e masave anti-korrupsion nga qeveria e tyre vendore.

Ky raport rekomandon që:

<sup>60</sup> <http://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/207>

- Njësitë e qeverisjes vendore duhet të forcojnë kapacitetet e tyre administrative nëpërmjet trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve për qeverisjen vendore dhe çështjeve anti-korrupsion dhe të rrisin njohuritë e tyre në lidhje me legjislacionin në fuqi.
- Njësitë e qeverisjes vendore të përfshira në këtë raport duhet të rrisin transparencën, duke ndërmarrë veprime konkrete, siç përcaktohet në legjislacionin përkatës, të tilla si përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion dhe forcimi i infrastrukturës elektronike të bashkive.
- OSHC-të që veprojnë në nivel vendor duhet të rrisin kapacitetet e tyre organizative dhe të kërkojnë mbështetje veçanërisht më ekspertizë për çështjet e anti-korrupsionit dhe qeverisjes së mirë.
- Aktorët e shoqërisë civile duhet ta përqendrojnë punën e tyre në qeverisjen e mirë dhe veprimet anti-korrupsion, rrisin kapacitetet organizative dhe të punojnë për të hartuar, menaxhuar dhe zbatuar projektet e tyre në bashkitë e tyre, rrisin njohuritë dhe ekspertizën e tyre kundër korrupsionit dhe qeverisjes së mirë nëpërmjet trajnimeve të shpeshta për ngritjen e kapaciteteve, rrisin vetëdijen në mesin e qytetarëve në lidhje me rolin e tyre në demokracinë vendore, fokusohen në monitorimin e aktivitetit dhe efektivitetit të bashkisë, nxisin vullnetarizmin dhe rrjetin e kontakteve, dhe përmirësojnë bashkëpunimin ndërmjet aktorëve të ndryshëm të komunitetit vendor.
- NJQV-të duhet të:
  - o Krijojnë instrumente konkrete për parandalimin, kontrollin dhe regjistrimin e korrupsionit.
  - o Miratojnë rregullore për raportimin e rasteve të korrupsionit.
  - o Krijojnë Strategji për Anti-Korrupsionin.
  - o Zbatojnë sistemet e tyre të menaxhimit të performancës.
  - o Vendosin rregulla të brendshme për të mbledhur të dhëna të mbi rastet e korrupsionit.
  - o Vendosin rregulla dhe procedura për njoftimin, shqyrtim, zbulimin dhe raportimin dobësive, mospërputhjeve dhe

shkeljeve administrative që krijojnë terren për korrupsion, mashtrim apo parregullsi.

- o Krijojnë faqen e tyre zyrtare të internetit si një mjet për transparencë dhe llogaridhënie, e cila do të rrisë dhe lehtësojë informacion për qytetarët.
- o Miratojnë Programin e Transparencës dhe emërojnë një Koordinator për Transparencën që të garantojë të drejtën e informimit.
- o Emërojnë një Koordinator për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, i cila të garantojë të drejtën e njoftimit dhe të konsultimit publik

OSHC-të dhe NJQV-të përbëjnë dy shtylla të rëndësishme në garantimin dhe forcimin e demokracisë në nivel vendor. Në momentin e shkrimit të këtij raporti, NJQV-ve dhe OSHC-të paraqesin kapacitete shumë të kufizuara në nivel vendor në terma të kapaciteteve institucionale dhe njerëzore. Për më tepër, bashkëpunimi ndërmjet NJQV-ve dhe OSHC-ve në nivel vendor është shumë i kufizuar. Për këtë arsye, NJQV-të dhe OSHC-të duhet të bëjnë më shumë përpjekje në zhvillimin e planeve të përbashkëta të veprimit dhe të çojnë përpara bashkëpunimin e tyre, duke ndërtuar ura komunikimi me aktorë të tjerë, të tillë si media dhe komuniteti vendor në tërësi.

# SHTOJCAT

## Shtojca I. Profili i Bashkive

### Profili i Bashkisë Ura Vajgurore

Bashkia Ura Vajgurore shtrihet në qendër të Shqipërisë dhe është pjesë e qarkut Berat. Ajo përbëhet nga 4 njësi administrative, 1 qytet dhe 34 fshatra<sup>61</sup> dhe ka një popullsi prej 27.295 banorësh.<sup>62</sup> Lidhur me ndarjen administrative, Bashkia Ura Vajgurore klasifikohet 53.5% urbane dhe 46.5% rurale.<sup>63</sup> Treguesit arsimorë<sup>64</sup> tregojnë që 69.1% (qarku 58.6%, vendi 52.1%) e popullsisë ka përfunduar vetëm arsimin 8/9 vjeçar; 22.1%; (qarku 29.85%, vendi 31.4%) – arsimin e mesëm; 4.1% (qarku 6.8%, vendi 11.8%) – arsimin universitar dhe pasuniversitar. Ekonomia mbështetet në sektorët e bujqësisë dhe shërbimeve. 67.3% e të punësuarve punojnë në sektorin e bujqësisë, ndjekur nga sektori i shërbimeve 22.1% dhe industria 10.6%.<sup>65</sup> Peshën kryesore të burimit të të ardhurave të NjEF-së e mbajnë të ardhurat nga puna e paguar ose vetëpunësimi 67.8%, ndjekur nga të ardhurat nga pensionet me 29.3%, paratë e dërguara nga jashtë shtetit 13.7% dhe ndihma sociale dhe përfitimet me 7.5%.<sup>66</sup> Shkalla e papunësisë në Urën Vajgurore është rreth 18.8% e forcës punëtore 15 vjeç e lart.<sup>67</sup> Ndërkohë, papunësia tek të rinjtë e moshës 15-24 vjeç arrin në 41.5%.<sup>68</sup> Njësitë Ekonomike Familjare me akses në

61 [http://www.reformaterritoriale.al/images/presentations/Ligji%20ndarja%20territoriale\\_Fletore\\_zyrtare.pdf](http://www.reformaterritoriale.al/images/presentations/Ligji%20ndarja%20territoriale_Fletore_zyrtare.pdf)

62 <http://instatgis.gov.al/#!/prefectures/population/prefpop1>

63 INSTAT, Një klasifikim i ri urban-rurale i popullsisë shqiptare

64 <http://instatgis.gov.al/#!/prefectures/population/prefpop1>

65 <http://instatgis.gov.al/#!/prefectures/population/prefpop1>

66 Po aty.

67 Po aty.

68 Po aty.



internet janë 3.3%.<sup>69</sup> Në buxhetin e vitit 2016 bashkisë i janë transferuar 127,537 mijë lekë.<sup>70</sup> Organi përfaqësues është Këshilli i Bashkisë, i përbërë nga 21 anëtarë<sup>71</sup> (14 meshkuj dhe 7 femra). Bashkia Ura Vajguore nuk ka ende një faqe zyrtare interneti.

### Profili i Bashkisë Bulqizë

Bashkia Bulqizë shtrihet në lindje të Shqipërisë dhe është pjesë e qarkut Dibër. Ajo përbëhet nga 8 njësi administrative, 12 qytete dhe 64 fshatra<sup>72</sup> dhe ka një popullsi prej 31.210 banorë.<sup>73</sup> Lidhur me ndarjen administrative, Bashkia Bulqizë klasifikohet 26.9% urbane dhe 73.1% rurale.<sup>74</sup> Treguesit arsimorë<sup>75</sup> tregojnë që (qarku 65.8%, vendi 52.1%) e popullsisë ka përfunduar vetëm arsimin 8/9 vjeçar; 22.7%; (qarku 24.26%, vendi 31.4%) – arsimin e mesëm; 4.0% (qarku 5.2%, vendi 11.8%) – arsimin universitar dhe pasuniversitar. Ekonomia mbështetet në sektorët e shërbimeve dhe bujqësisë. 36.7% e të punësuarve punojnë në sektorin e shërbimeve, ndjekur nga bujqësia 34.5% dhe industria 28.7%.<sup>76</sup> TPeshën kryesore të burimit të ardhurave të NJEF-së e mbajnë të ardhurat nga puna e paguar ose vetëpunësimi 41.2%, ndjekur nga të ardhurat nga pensionet me 34.7%, ndihma sociale dhe përfitimet me 31.1% dhe paratë e dërguara nga jashtë shtetit 8.7%.<sup>77</sup> Shkalla e papunësisë në Bulqizë është rreth 38.5% e forcës punëtore 15 vjeç e lart.<sup>78</sup> Ndërkohë, papunësia tek të rinjtë e moshës 15-24 vjeç arrin në 64.3%.<sup>79</sup> Njësitë Ekonomike Familjare me akses në internet janë 2.2%.<sup>80</sup> Në buxhetin e vitit 2016 bashkisë i janë transferuar 288,429 mijë lekë.<sup>81</sup> Organi përfaqësues është Këshilli i Bashkisë i përbërë nga 21 anëtarë<sup>82</sup> (18 meshkuj dhe 3 femra). Bashkia Ura Vajguore nuk ka ende një faqe zyrtare interneti.

### Profili i Bashkisë Klos

Bashkia Klos shtrihet në lindje të Shqipërisë dhe është pjesë e qarkut Dibër. Ajo përbëhet nga 4 njësi administrative, 1 qytet dhe 30 fshatra<sup>83</sup> dhe ka një popullsi

69 Po aty.

70 <http://www.financa.gov.al/raportime/buxheti/buxheti-i-pushtetit-vendor-2016>

71 [http://www.cec.org.al/Portals/0/Documents/CEC%202013/zgjedhje-vendore/2015/rezultatet/keshilltaret/151210\\_-\\_DTI\\_-\\_keshilltaret\\_2015.htm](http://www.cec.org.al/Portals/0/Documents/CEC%202013/zgjedhje-vendore/2015/rezultatet/keshilltaret/151210_-_DTI_-_keshilltaret_2015.htm)

72 Ligji Nr. 115/2014 "Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësisve të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë".

73 <http://instatgis.gov.al/#!/prefectures/population/prefpop1>

74 INSTAT, Një klasifikim i ri urban-rurale i popullsisë shqiptare

75 <http://instatgis.gov.al/#!/prefectures/population/prefpop1>

76 <http://instatgis.gov.al/#!/prefectures/population/prefpop1>

77 Po aty.

78 Po aty.

79 Po aty.

80 Po aty.

81 <http://www.financa.gov.al/raportime/buxheti/buxheti-i-pushtetit-vendor-2016>

82 [http://www.cec.org.al/Portals/0/Documents/CEC%202013/zgjedhje-vendore/2015/rezultatet/keshilltaret/151210\\_-\\_DTI\\_-\\_keshilltaret\\_2015.htm](http://www.cec.org.al/Portals/0/Documents/CEC%202013/zgjedhje-vendore/2015/rezultatet/keshilltaret/151210_-_DTI_-_keshilltaret_2015.htm)

83 Ligji Nr. 115/2014 "Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësisve të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë".

prej 16.618 banorë.<sup>84</sup> Lidhur me ndarjen administrative, Bashkia Klos klasifikohet 22.8% urbane dhe 77.2% rurale.<sup>85</sup> Treguesit arsimorë<sup>86</sup> tregojnë që 68.5% (65.8% qarku, 52.1% vendi) e popullsisë ka përfunduar vetëm arsimin 8/9-vjeçar,<sup>87</sup> 20.6% (24.26% qarku, 31.4% vendi) - arsimin e mesëm;<sup>88</sup> 4.1% (5.2% qarku, 11.8% vendi) - arsimin universitar dhe pasuniversitar. Ekonomia mbështetet në sektorët e bujqësisë dhe shërbimeve. 68.6% e të punësuarve punojnë në sektorin e bujqësisë, ndjekur nga sektori i shërbimeve 23.2% dhe industria 8.2%.<sup>89</sup> Peshën kryesore të burimit të të ardhurave të NjEF-së e mbajnë të ardhurat nga pensionet me 39.4%, ndjekur nga të ardhurat nga puna e paguar ose vetëpunësimi 38.4%, ndihma sociale dhe përfitimet me 35.5% dhe paratë e dërguara nga jashtë shtetit 6.4%.<sup>90</sup> Shkalla e papunësisë në Klos është rreth 31.2% e forcës punëtore 15 vjeç e lart.<sup>91</sup> Ndërkohë, papunësia tek të rinjtë e moshës 15-24 vjeç arrin në 58.5%.<sup>92</sup> Njësitë Ekonomike Familjare me akses në internet janë 0.4%.<sup>93</sup> Në buxhetin e vitit 2016 bashkisë i janë transferuar 105.643 mijë lekë.<sup>94</sup> Organi përfaqësues është Këshilli i Bashkisë i përbërë nga 21 anëtarë<sup>95</sup> (18 meshkuj dhe 3 femra). Bashkia Klos nuk ka ende një faqe zyrtare interneti.

### Profili i Bashkisë Shijak

Bashkia Shijak shtrihet në qendër të Shqipërisë dhe është pjesë e qarkut Durrës. Ajo përbëhet nga 4 njësi administrative, 1 qytet dhe 25 fshatra<sup>96</sup> dhe ka një popullsi prej 34.513 banorë.<sup>97</sup> Lidhur me ndarjen administrative, Bashkia Shijak klasifikohet 100% urbane dhe 0.0% rurale.<sup>98</sup> Treguesit arsimorë<sup>99</sup> tregojnë që 64.4% (654.6% qarku, 52.1% vendi) e popullsisë ka përfunduar vetëm arsimin 8/9-vjeçar; 25.7% (31.48% qarku, 31.4% vendi) - arsimin e mesëm; 5.4% (9.7% qarku, 11.8% vendi) - arsimin universitar dhe pasuniversitar. Ekonomia mbështetet në sektorët e shërbimeve dhe industrisë. 52.0% e të punësuarve punojnë në sektorin e shërbimeve, ndjekur nga industria 24.7% dhe bujqësia 23.3%.<sup>100</sup> Peshën kryesore të burimit të të ardhurave të NjEF-së e mbajnë të ardhurat nga puna e paguar ose vetëpunësimi 57.8%, ndjekur nga pensionet me 31.5%, paratë e dërguara nga jashtë

84 <http://instatgis.gov.al/#/l/prefectures/population/prefpop1>

85 INSTAT, Një klasifikim i ri urban-rurale i popullsisë shqiptare

86 <http://instatgis.gov.al/#/l/prefectures/population/prefpop1>

87 <http://instatgis.gov.al/#/l/prefectures/population/prefpop1>

88 Po aty.

89 Po aty.

90 Po aty.

91 Po aty.

92 Po aty.

93 Po aty.

94 <http://www.financa.gov.al/al/raportime/buxheti/buxheti-i-pushtetit-vendor-2016>

95 [http://www.cec.org.al/Portals/0/Documents/CEC%202013/zgjedhje-vendore/2015/rezultatet/keshilltaret/151210\\_-\\_DTL\\_-\\_keshilltaret\\_2015.htm](http://www.cec.org.al/Portals/0/Documents/CEC%202013/zgjedhje-vendore/2015/rezultatet/keshilltaret/151210_-_DTL_-_keshilltaret_2015.htm)

96 Ligji Nr. 115/2014 "Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësitë të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë".

97 <http://instatgis.gov.al/#/l/prefectures/population/prefpop1>

98 INSTAT, Një klasifikim i ri urban-rurale i popullsisë shqiptare

99 <http://instatgis.gov.al/#/l/prefectures/population/prefpop1>

100 Po aty.

shtetit 13.0% dhe ndihma sociale dhe përfitimet me 5.5%.<sup>101</sup> Shkalla e papunësisë në Shijak është 25.9% e forcës punëtore 15 vjeç e lart.<sup>102</sup> Ndërkohë, papunësia tek të rinjtë e moshës 15-24 vjeç arrin në 46.8%.<sup>103</sup> Njësitë Ekonomike Familjare me akses në internet janë 8.8%.<sup>104</sup> Në buxhetin e vitit 2016 bashkisë i janë transferuar 143,489 mijë lekë.<sup>105</sup> Organi përfaqësues është Këshilli i Bashkisë i përbërë nga 21 anëtarë<sup>106</sup> (14 meshkuj dhe 7 femra). Bashkia Shijak nuk ka ende një faqe zyrtare interneti.

### Profili i Bashkisë Cërrik

Bashkia Cërrik shtrihet në qendër të Shqipërisë dhe është pjesë e qarkut Elbasan. Ajo përbëhet nga 5 njësi administrative, 1 qytet dhe 28 fshatra<sup>107</sup> dhe ka një popullsi prej 27.445 banorë.<sup>108</sup> Lidhur me ndarjen administrative, Bashkia Cërrik klasifikohet 100% urbane dhe 0.0% rurale.<sup>109</sup> Treguesit arsimorë<sup>110</sup> tregojnë që 66.2% (59.6% qarku, 52.1% vendi) e popullsisë ka përfunduar vetëm arsimin 8/9-vjeçar; 23.6% (26.63% qarku, 31.4% vendi) - arsimin e mesëm; 4.3% (8.0% qarku, 11.8% vendi) - arsimin universitar dhe pasuniversitar. Ekonomia mbështetet në sektorët e bujqësisë dhe shërbimeve. 61.6% e të punësuarve punojnë në bujqësi, ndjekur nga sektori i shërbimeve 23.7% dhe industria 14.7%.<sup>111</sup> Peshën kryesore të burimit të të ardhurave të NjEF-së e mbajnë të ardhurat nga puna e paguar ose vetëpunësimi 51.2% ndjekur nga pensionet 31.0%, paratë e dërguara nga jashtë shtetit 21.4% dhe ndihma sociale dhe përfitimet me 11.8%.<sup>112</sup> Shkalla e papunësisë në Cërrik është 17.8% e forcës punëtore 15 vjeç e lart.<sup>113</sup> Ndërkohë, papunësia tek të rinjtë e moshës 15-24 vjeç arrin në 35.3%.<sup>114</sup> Njësitë Ekonomike Familjare me akses në internet janë 4.8%.<sup>115</sup> Në buxhetin e vitit 2016 bashkisë i janë transferuar 160,091 mijë lekë.<sup>116</sup> Organi përfaqësues është Këshilli i Bashkisë i përbërë nga 21 anëtarë<sup>117</sup> (12 meshkuj dhe 9 femra). Bashkia Cërrik nuk ka ende një faqe zyrtare interneti.

101 Po aty.

102 Po aty.

103 Po aty.

104 Po aty.

105 <http://www.financa.gov.al/raportime/buxheti/buxheti-i-pushtetit-vendor-2016>

106 [http://www.cec.org.al/Portals/0/Documents/CEC%202013/zgjedhje-vendore/2015/rezultatet/keshilltaret/151210\\_-\\_DTL\\_-\\_keshilltaret\\_2015.htm](http://www.cec.org.al/Portals/0/Documents/CEC%202013/zgjedhje-vendore/2015/rezultatet/keshilltaret/151210_-_DTL_-_keshilltaret_2015.htm)

107 [http://www.reformaterritoriale.al/images/presentations/Ligji%20ndarja%20territoriale\\_Fletore\\_zyrtare.pdf](http://www.reformaterritoriale.al/images/presentations/Ligji%20ndarja%20territoriale_Fletore_zyrtare.pdf)

108 <http://instatgis.gov.al/#!/l/prefectures/population/prefpop1>

109 INSTAT, Një klasifikim i ri urban-rural i popullsisë shqiptare

110 <http://instatgis.gov.al/#!/l/prefectures/population/prefpop1>

111 Po aty.

112 Po aty.

113 Po aty.

114 Po aty.

115 Po aty.

116 <http://www.financa.gov.al/raportime/buxheti/buxheti-i-pushtetit-vendor-2016>

